

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7629 E enjte 23 Gusht 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nisma e një grupi intelektualësh me fokus dekomunistizimin e shoqërisë është jo pak befásuese. Dhe surprizuese! Jo sepse nismës, të paktën nga ato që shkruhen ...
Vijon në faqen 20

Nga VALBONA NATHANAILI

Ta çojmë diktaturën në muze!



Opinion

Ditës

Është kthyer tashmë në një rutinë të qetë, sa herë partitë politike shqiptare kanë nevojë për të krijuar debat në atë se kush e do më shumë e kush më pak ...
Vijon në faqen 21

Nga TAULANT MALAJ

Një Shqipëri e fortë apo një shërbëtore e BE-së?!



Fotot/ Presidenti në festën e bektashinjve

Meta në pelegrinazh në Tomor: Abaz Aliu, misionari që ndriçoi të gjithë njerëzimin

Kreu i shtetit falënderon Kryegjyshin Edmond Brahimaj: Kemi nevojë ta duam njëri-tjetrin

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje paradite në pelegrinazhin në malin e Tomorit, ku përshëndeti Festën e shenjtë Bektashiane të Abaz Aliut. Në prani të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Baba Edmond Brahimaj dhe mijëra besimtarëve bektashianë, Presidenti Meta vlerësoi pelegrinazhin e përvitshëm ...

Në faqen 11

INSTITUTI I SIGURIMEVE: SI MUND TE "BLINI" VITET E VJETERSISE NE PUNE

PENSIONET, SI BEHET SIGURIMI VULLNETAR

Pagesat dhe përfitimet sipas kategorive për të vetëpunësuarit dhe emigrantët. Kontributi vullnetar, si mund të bleni vitet me 5 mijë lekë në muaj



(Në foto) Instítuti i Sigurimeve Shoqërore

Në faqen 9

BIZNESMENI NE GREQI

Lirohet Edmond Bego, PD: Përfitoi tenderin 100 milionë lekë nga maxhoranca

Në faqen 2-3

ESE

Ylli Polovina: Ide skandaloze, pse të mos kthehet në Kuçovë Stalini prej bronzi?

Në faqen 18-19

INTERVISTA

Gentian Zenelaj: Politikanëve antishqiptarë do t'u hiqja vizën

Suplement

INTERVISTA

Luçiano Boçi: PD, propozim që 'Antimafia' të prekë njerëzit me pushtet

Në faqen 4-5

LISTA EMERORE



Dosjet e viteve 2013-'14, pronarët që përfitojnë nga kompensimi

Në faqen 7

39-vjeçari Roland Shëmbitrasi u ekzekutua në Athinë, shteti i merr paratë familjes

E vranë në 2017, 1 milionë euro nën sekuestro

Policia: Dyshohet se kanë ardhur nga trafiku i drogës në Greqi

Nga INAALLKANJARI

Rreth 1 milionë euro Rlllogari bankare janë sekuestruar nga policia në kuadër të operacionit "Porca e ligjit". Sipas Policisë së Shtetit dyshohet që paratë të jenë përfituar nga aktiviteti kriminal i trafikut



të drogës në Greqi. Behet me dije se personit, të cilit i është sekuestruar shuma e parave, e cila dyshohet se është përfituar nga trafiku i drogës është Roland Shëmbitrasi me origjinë nga Korça dhe banim në Librazhd. Shëmbitrasi, u ...

Në faqen 8

LIRIMI I BEGOS REAGIMET

Ish-i dënuar për trafik droge, Ardian Leka: I përfundoi detyrimet e tij në 2014

Lirohet biznesmeni Bego, Interpol Roma: Nuk është në kërkim

Avokati: Arrestimi në Greqi, i qëllimshëm

Ina Allkanjari

Autoritete greke kanë liruar ditën e djeshme biznesmenin Edmond Bego, i cili u arrestua pak ditë më parë për llogari të shtetit italian, teksa kthehej për në Shqipëri nga pushimet në Korfuz. Biznesmeni u lirua pas përgjigjes që pritej nga Interpol Roma drejt Interpol Athinës ku thuhej se ndaj Begos nuk ka asnjë çështje të hapur dhe nuk ka dënim për të shlyer në vendin fqinj për akuzën e trafikut të drogës. Kujtojmë se gjatë ndalimit nga policia greke, 48-vjeçari kishte deklaruar se i kishte shlyer detyrimet e tij me drejtësinë dhe se po e arrestonin padrejtësisht. Ndërkohë Ardian Leka, avokati i Edmond Begos u shpreh në lidhje me këtë çështje se pas vitit 2009 emri i klientit të tij nuk ka ekzistuar në sistem dhe se dyshon se ndalimi nga Greqia ka qenë i qëllimshëm e jo një gabim. Gjithashtu, Leka tregoi se Bego është i liruar dhe është nisur drejt Shqipërisë. "Edmond Bego u lirua, është nisur drejt Shqipërisë. Përgjigja erdhi mbrëmë nga Interpol Roma. Prokurorja e Apelit nxori urdhrin e lirimit. Bego s'ka pasur çështje të hapur pas 2009. Në 2009 Bego është arrestuar nga shteti shqiptar. Ai i përfundoi detyrimet e tij në 2014. Është njësoj si me radhë e gjata në doganë. Ky emër në sistem nuk ka ekzistuar asnjëherë nga viti 2009 e në vazhdim. Kjo është situata. Këtë gjë e kemi peshqesh nga shteti grek", deklaroi avokati. Më tej avokati theksoi se do të konsultohet me kolegët grekë dhe më pas do nisë procedurat për ankimim. "Kjo është një procedurë që do fillojë në shte-



Biznesmeni Edmond Bego



Avokati Ardian Leka

tin grek nga avokatët grekë. Pas konsultimit në Shqipëri do fillojmë procedurën. Mendojmë se është një gjë me dashje, jo gabim, por ky është mendimi im", tha avokati i Edmond Begos. Në lidhje me këtë çështje pati reagim edhe nga Policia e Shtetit, e cila theksoi se pas verifikimeve, rezultoi se shtetasi Edmond Bego nuk është në kërkim kombëtar dhe ndërkomëtar nga autoritetet policore shqiptare për llogari të ndonjë shteti tjetër. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, Bego ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018. "Nga verifikimet e kryera në sistemin TIMS, shtetasi në fjalë ka dalje dhe hyrje nga territori shqiptar nga vitet 2013 deri në vitin 2018, edhe drejt Italisë. Ai

në territorin italian ka hyrë 3 herë në vitin 2017, dhe në datë 13 korrik në vitin 2018. Bego në datë 8 gusht 2018 ka dalë nga PKK Qafë Botë drejt territorit grek, siç ka bërë edhe më herët në vitet 2014, 2015, 2016, 2017 dhe 2018, në disa raste në mënyrë të përsëritur. Pra, për këtë shtetas nuk ka pasur asnjë urdhrë tjetër ndalimi ndërkomëtar përveç urdhrin të ndalimit të ekzekutuar nga Policia e Shtetit në vitin 2009, që do të vinte në lëvizje Interpol Tiranë dhe Policinë e Shtetit, apo ndonjë kërkesë nga autoritetet italiane dhe misionet e tyre policore në Tiranë, ndryshe nga sa u deklarua nga subjekti politik Partia Demokratike", theuë në reagimin e Policisë së Shtetit. Edmond Bego, pranon i disa bi-

AVOKATI

"Edmond Bego u lirua, është nisur drejt Shqipërisë. Përgjigja erdhi mbrëmë nga Interpol Roma. Prokurorja e Apelit nxori urdhrin e lirimit. Bego s'ka pasur çështje të hapur pas 2009. Në 2009 Bego është arrestuar nga shteti shqiptar. Ai i përfundoi detyrimet e tij në 2014.", deklaroi avokati.



"Të mos e përdorim të shkuarën e dikujt për kapital politik"

Imami i del në mbrojtje biznesmenit Bego: Shoqëria jonë, e etur për t'i bërë gjyqin njerëzve

Imami Ahmed Kalaja i ka dalë ditën e djeshme në mbrojtje biznesmenit shqiptar duke u shprehur se Edmond Bego e ka shlyer dënimin dhe është penduar para Zotit. Kalaja shkruan se fatkeqësisht shoqëria jonë, e etur për t'i bërë gjyqin njerëzve si dikur, ia kalon dhe Gjykatës Suprem duke ia përmendur gjithmonë gabimin edhe nëse për këtë gabim e ke marrë një herë dënimin. "Një qytetar, i cili e ka shlyer dënimin dhe ka plotësisht të drejtën të jetojë i qetë nga hijet e së shkuarës", shkruan Kalaja. "Rasti i Mond Begos, Zoti i falte abuzuesit me dinjitetin e tij! I penduari nga një gabim konsiderohet si një i pafajshëm tek Zoti. Kështu sanksiononte Profeti Muhamed para 15 shekujsh. Mirëpo Islami nuk është mjaftuar me kaq ponamëshon se vuajtja e dënimit është pjesë e pendimit si edhe



domosdoshmëri për funksionimin e pendimit, siç edhe na mëson se në momentin që drejtësia të dënon për një gabim dhe ti e vuan atë dënim nuk ka kush më të drejtë të hedhë baltë mbi dinjitetin e dikujt. Por fatkeqësisht shoqëria jonë, e etur për t'i bërë gjyqin njerëzve si dikur, ia kalon dhe Gjykatës Suprem duke ia përmendur gjithmonë gabimin edhe nëse për këtë gabim e ke marrë një herë dënimin. Kështu po ndodh dhe

me rastin e Mond Begos. Një qytetar, i cili e ka shlyer dënimin dhe ka plotësisht të drejtën të jetojë i qetë nga hijet e së shkuarës. Në statusin e imamit të xhamisë që z. Bego frekuentonte, më lind e drejta të them se e njoh si një njeri të rregullt dhe korrekt. Një familjar që sakrifikoje gjithçka për edukimin dhe shkollimin e fëmijëve të tij. Por jo vetëm, ai është prind dhe për shumë jetimë, duke u dhënë pension muajor shumë prej tyre, e disa të tjerëve u ka rregulluar dhe shtëpitë, përkushtimet e tij ndaj njerëzve në nevojë saqë një status do të zgjatej shumë edhe do të humbte sensin, po që jam i sigurt se ai kurrë nuk do ta dëshironte që të përmendim gjëra të tilla se qëllimi i tij nuk ka qenë reklamimi.", shkruan Imam Ahmet Kalaja.

zneseve në Shqipëri, i njohur dhe me katër emra të tjerë e ka kryer dënimin e shtetit italian për akuzat e pjesëmarrjes dhe krijimit të organizatave kriminale,

kontrabandës dhe trafikimit të drogës, heroinë dhe kokainë, në Shqipëri. Ai është dënuar në vitin 2008 nga Gjykata e Apelit e Torinos me 21 vite heqje lirie. Ai u arres-

tua në vendin tonë në vitin 2009 dhe në 15 shtator 2010, Gjykata e Lartë ia konvertoi dënimin nga 21 vite burg që e kishte dënuar drejtësia italiane, në 4 vite e 4 muaj.



Balla, përgjigje Spahos: Disa janë votuar vetëm për të bërë llafe...

PD publikon dokumentet: Bego fitoi tenderin 100 milionë lekë

"Balla sekser i biznesmenit"

Valentina Madani

Partia Demokratike publikoi dje dokumente që sipas saj faktojnë se biznesmeni Edmond Bego ka fituar miliona nga buxheti i shtetit falë lidhjeve me politikën. Kreu i Grupit Parlamentar të PD-së Edmond Spaho i kërkoi socialistit Taulant Balla "të tregojë a ka hyrë sekser që miku i tij kriminel të fitojë tenderin 100 milionësh nga OST në Librazhd". "Arrestimi i trafikantit ndërkombëtar të drogës, Edmond Bego, mik familjar i kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla është dëshmia më e freskët sesi Edi Rama ka kriminalizuar gjithçka, që nga zyra ku punon, deri tek paratë që u merr shqiptarëve me taksa gjithnjë e më të larta", deklaroi z.Spaho. Zyrtaari i lartë i PD-së publikoi sipas tij një provë zyrtare sesi buxheti i shtetit është vënë në shërbim të mikut kriminel të Taulant Ballës, i cili tha dje se nuk ishte përdorur si mburojë politike për ish-anëtarin e bandës së Lushnjës. "Të dhënat zyrtare tregojnë se kompania 'Inerte Express', me pronar trafikantin e drogës dhe mikun e familjes së Taulant Ballës, nuk ka përvojë në ndërtimin e nën-stacioneve elektrike dhe se këtë funksion ai e shtoi në fund të dhjetorit 2017. Pak muaj më vonë, kompania pa përvojë e mikut trafikant droge të Taulant Ballës përfitoi një tender publik nga Operatori i Sistemit të Transmimit", deklaroi Spaho. Sipas tij, 'dokumentet tregojnë se tenderi i OST-së me vlerë 100 milionë lekë i është dhënë trafikantit të dënuar me 21 vjet burg për drogë, në fillim të verës, në zemër të zonës elektorale të Taulant Ballës, në Librazhd". "Kolegu im, kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla duhet t'u thotë shqiptarëve a ka bërë ai sekserin me OST-në, që miku i tij trafikant droge të fitojë një tender prej 100 milionë lekë? Sa më shumë të heshtë Taulanti pa sqaruar çfarë e lidh atë me miqësi familjare me një trafikant të rrezikshëm droge, që autoritetet italiane e kanë dënuar me 21 vjet burg, aq më shumë forcohet bindja për rolin e Taulant Ballës si sekser të miliona eurove që ia merr shqiptarëve për t'ndarë me trafikantin e drogës", tha Spaho.

REAGIMI...



EDI RAMA

Një ditë pas aksidentit tragjik në aksin Levan-Fier ku humbi jetën një grua shtatzënë, kryeministri Rama shkruan në 'Fb' mbi projektin e unazës së Fierit. "Me këtë projekt të Programit Kombëtar të Rrugëve Kombëtare, që pas dekadash ka kthyer në standarde normale unazën lindore të Fierit, ju uroj një ditë të mbarë! Punimet që nisnin në vjeshtë për Bypass-in e Fierit do të bëjnë të mundur çlirimin e plotë të trafikut të automjeteve drejt jugut në sezonin e ardhshëm veror", shkruan Rama.

YLLI MANJANI

"Shqipëria sot nuk ka Gjykatë Kushtetuese. Ajo që nuk po sheh ky popull sot, nuk po sheh cila është alternativa. Në qoftë se nuk shfaqesh dot si një alternativë më e mirë se kjo që është koston e merr ti", tha Manjani.



Ndahet nga jeta ish deputeti i PD, Basha: Ferizaj, njeri i kauzave të mëdha

Ish-deputeti i PD-së, Ismet Ferizaj ndërroi jetë në moshën 75-vjeçare. Lajmin e hidhur e bëri të ditur vetë familja e tij. Ferizaj prej disa kohësh vuante nga një sëmundje e pashërueshme, e cila sot i mori jetën. Kujtojmë që Ismet Ferizaj përpara pak muajsh u nderua nga Bashkia e Kavajës me titullin e lartë "Qytetar Nderi" i Kavajës për kontributin e tij në politikë, por edhe si ish-drejtor i shkollës "3 Dëshmorët". Ferizaj është themelues i PD-së dhe deputet i saj në vitet 1992-1997 si dhe themelues i shtypshkronjës së parë në Kavajë "Gutenberg". Kreu i PD-së, Lulzim Basha shkruan se Ferizaj ishte një patriot që për shumë vite u përndoi nga regjimi komunist. "Patriot i shpërngulur nga Kosova bashkë me familjen e tij, i ndjekur nga regjimi komunist, ai iu bashkua që në fillim PD, si themelues e më pas deputet në Kuvendin e Shqipërisë. I pandarë në çdo sfidë e betejë nga kauzat e mëdha të PD, Ismet Ferizaj ndërthurte vlerat më të larta patriotike me qëndrueshmëri dhe kthjelltësinë e mendimit intelektual. Për kontributin e tij të shquar qytetar, politik dhe intelektual, Bashkia Kavajë e ka nderuar me titullin e lartë "Qytetar Nderi", - shprehet z.Basha.

Abuzimet tek ALUIZNI, Berisha: Drejtuesit që çojnë zarfet te Lame

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje mesazhin e një qytetari dixhital që denoncon afëra korruptive dhe shkelje në ALUIZNI-n e Tiranës. Sipas denoncuesit nga kontrolli i Task-Forcës i janë gjetur shkelje zëvendës regjistrueses pranë Hipotekës së Tiranës, Besa Spaho. Ai shprehet se Spaho dhe drejtori i ALUIZNI-t Tiranë Daniel Naço kanë dhënë leje legalizimi duke zhdukur aktin e kualifikimit të dosjeve. "Në drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana-Jug nga kontrolli i ngritur nga Task Forca u konstatuan shkelje të mëdha ish-drejtoreshës zj. Besa Spaho aktualisht zëvendës regjistruese pranë ZVRPP Tiranë, kandidatet e 28-ta në listën e Tiranës. Shkelja u konstatua edhe për ish-shefin e legalizimeve z. Daniel Naço aktualisht



drejtor ALUIZNI në Tiranë. Kanë dhënë leje legalizimi duke zhdukur aktin e kualifikimit të dosjeve, ne dosje janë gjetur vetëm vetëdeklarimi dhe fotot e objektit pasi dosja është e certifikuar. Të dy këta titullarë sot janë të kallëzuar penalisht nga Task Forca. Besa Spaho shkel çdo lloj kondicioni teknike e ligjor kundrejt rryshfeteve që i merr qytetarëve dhe duke i dhënë Artan Lames dhe zj. Brikena Dervishaj. Të dy këta per-

sona qëndrojnë në punë për shkak të kafeve që dërgojnë të shefat e tyre, jo për shkak të meritokracisë. Znj Spaho përpara se të largohet nga kjo detyrë për në detyrën e re iu dha urdhër të gjithë specialistëve që të mos i bindeshin drejtoreshës së re zj. Irma Shtini pasi kish plane për të vendosur sërish Daniel Nacon pasi me të kishte lidhje përtej detyrës shtetërore", thuhet në denoncimin drejtuar Berishës.

Kreu i Grupit Parlamentar Taulant Balla i është përgjigjur akuzave të PD-së në lidhje me biznesmenin Edmond Bego nga Elbasani kur inspektori me kryetarin e bashkisë Qazim Sejdimi punimet për rikonstruksionin e rrugëve "Çauš Asllani" dhe "Ismail dhe Xhemali Debrova". Balla i quajti shpifje akuzat e deputetit demokrat Edmond Spaho se Edmond Bego ka përfituar 1 miliard lekë nga buxheti i shtetit nëpërmjet një tenderi të OST. Ai tha se disa janë vo-

EDI RAMA

Një ditë pas aksidentit tragjik në aksin Levan-Fier ku humbi jetën një grua sh-

tatzënë, kryeministri Rama shkruan në 'Fb' mbi projektin e unazës së Fierit. "Me këtë projekt të Programit Kombëtar të Rrugëve Kombëtare, që pas dekadash ka kthyer në standarde normale unazën lindore të Fierit, ju uroj një ditë të mbarë! Punimet që nisnin në vjeshtë për Bypass-in e Fierit do të bëjnë të mundur çlirimin e plotë të trafikut të automjeteve drejt jugut në sezonin e ardhshëm veror", shkruan Rama.

STRATEGJIA E OPOZITËS

INTERVISTA

Valentina Madani

Deputeti dhe anëtari i kryesisë së PD-së Luçiano Boçi paralajmëron rinisjen e protestave në mbarë vendin kundër qeverisë "Rama". Z.Boçi tregon për "Gazeta Shqiptare" se betejat politike nuk do jenë thjeshtë e vetëm deklarative e denoncuese. Sipas tij synimi i tyre në formë dhe përmbajtje, përfshirë dhe protestat masive, do jetë i fokusuar në arritjen e qëllimit që sot e kërkon pjesa dërmuese e shqiptarëve, të largimit të Ramës nga drejtimi i vendit. Luçiano Boçi teksa akuzon Edi Ramën për deformimin e drejtësisë garanton se opozita nuk do të lejojë ligjërimin e krimit të organizuar qeveritar e atë të rrugës, dhe as skena mbi të cilën hidhet vallja e vdekjes së demokracisë. Zyrta i lartë demokrat flet dhe për amendimin e ligjit anti-mafia: "Propozimet e deklamuara nga z.Basha janë një detajim i kuadrit ligjor dhe zgjerimin i profileve të krimit të organizuar, përfshi PPP-të korruptive si dhe fushëveprimin e ligjit antimafia që do të prekte jo vetëm ministrin e Brendshëm, por dhe një radhë të gjatë pushtetarësh, përfshirë pse jo dhe Ramën, pasuria e të cilit sipas OSBE kalon 200 milionë euro. Parashikohet të ketë rezistencë nga mazhoranca, sepse këta i tremben asaj që vjen më pas dhe për më tepër e dinë mirë se çfarë kanë gatur".

Z. Boçi, cili do të jetë skenari i opozitës kundër qeverisë "Rama", i paralajmëruar për në muajin shtator?

Aksionet politike nuk janë scoop-e televizive, për të ngacmuar shijet e befasitë e publikut. Ato janë organizim, pjesëmarrje, idealitet, synim e kontribut qytetar për këdo që aspiron për familjen, vendin e progresin e shoqërisë. Sikurse janë domosdoshmëri që vetë situata politike i kërkon. Aksioni politik real opozitar ka pasur në vazhdimësi zgjatimet dhe e format e tij dhe përgjatë këtyre ditëve vere. Intensiteti i tij do jetë më thellë me fillimin e shtatorit e më tej, me një alternim të gjithë potencialeve dhe mjeteve që një opozitë i disponon. Betejat politike nuk do jenë thjeshtë e vetëm deklarative e denoncuese. Synimi i tyre në formë dhe përmbajtje, përfshirë dhe protestat masive, do jetë i fokusuar në arritjen e qëllimit që sot e kërkon pjesa dërmuese e shqiptarëve, të largimit të Ramës nga drejtimi i vendit. Situata social-ekonomike ka

Deputeti demokrat: Protesta dhe denoncime, Shqipëria s'mund të shndërrohet në një vend-kufomë

Propozimet e PD, Boçi: Pushtetarët që do prekë ligji antimafia

"Parashikohet të ketë rezistencë nga mazhoranca"



degraduar në atë pikë, sa vetëm një zgjidhje e re politike do krijonte mundësinë e ndaljes së rrënimit, braktitjes progresive të vendit dhe kthimit në një normalitet social tërësor. Shqipëria nuk duhet dhe nuk mund të shndërrohet në një vend-kufomë, pa rini, pa shpirt, pa qytetari, pa revoltë.

A është e gatshme opozita të dialogojë me mazhorancën për miratimin e reformave integruese? Një ftesë e hapur për dialog, mazhoranca e la të hapur për opozitën sesionin që shkoj, por si i shihni thirrjet e PS-

synojnë kapjen politike të shtetit e që ligjërojnë krimin e organizuar qeveritar e atë të rrugës.

Dhe as skena mbi të cilën hidhet vallja e vdekjes së demokracisë.

Ftesat për bashkëpunim nuk mund të jenë si letrat emocionale të keqbërësit, i cili shtrin dorën e tij vetëm e vetëm, për të bërë krimin e radhës, siç bën Rama. Dialogu i vërtetë nis kur keqbërësi merr dënimin e merituar dhe ulet në tavolinë me statusin e "pentitosa" ndaj opinionit publik e politik. Në këtë kontekst ftesa e mazhorancës nuk ka as

shpresë e përpjekje për të ardhmen në këtë vend.

Që ka kriminalizuar çdo sektor e çdo skutë të saj dhe që prodhon e fabrikon pandërprerë vrer, urrejtje, e maskarallëk ndaj opozitës dhe çdo qëndrimi qytetar opozitar. Është kjo mazhorancë që është sulur me "kazmë" në dorë historisë e vlerave shpirtërore e njerëzore në emër të përfitimeve monetare marramendëse me të cilat do t'u marrë mendjen njerëzve në ditë zgjedhesh. Kësisoj dialogu me Ramën është pa sens, pasi jemi para një kryeministri keqbërës sociopat e serial-

I vetmi dialog që Rama duhet të degjojë e t'i përgjigjet, është kërkesa e detyrimi për largimin e tij.

Parlamenti dështoi në votimin për disa ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilat synojnë t'i hapin rrugë pranimëve të reja në shkollën e magistraturës dhe emërimet të magistratëve të rinj të diplomuar tanimë. Shkak është bërë opozita. Konkretisht si mund të zgjidhet ngërçi me Shkollën e Magistraturës? A do japë opozita konsensus për miratimin në Kuvend?

Nuk ka dështuar parlamenti në këtë rast, pasi ky parlament nuk ka qenë e nuk është, me atë formë si është përfutur e si drejtohet.

Ka dështuar mazhoranca. Dhe nuk bëhet fjalë për ndryshimin e ligjit për statusin e gjyqtarëve e prokurorëve që është pjesë integrale e reformës në drejtësi, por bëhet fjalë për ndryshime në ligjin për Shkollën e Magistraturës. Për kujtesë, ky ligj u ndryshua nga kjo mazhorancë me shumicë të thjeshtë në 2014, me synimin kapjen e plotë politike të saj, gjë që u realizua më së miri. Tashmë dihet se si ajo komandohet nga drejtuesi e bordi politik. Thëksimi absurd i rolit të saj emëruar e përgjehdesh, çon ujën e drejtësisë tek mulliri i PS.

Në thelb, ndryshimet e kërkuara devijojnë institucionet kushtetuese të re-

DIALOGU

"Është kjo mazhorancë që është sulur me "kazmë" në dorë historisë e vlerave shpirtërore e njerëzore në emër të përfitimeve monetare marramendëse me të cilat do t'u marrë mendjen njerëzve në ditë zgjedhesh. Kësisoj dialogu me Ramën është pa sens, pasi jemi para një kryeministri keqbërës sociopat e serial-", deklaroi z. Boçi.

formës në drejtësi, si KLP e KLGJ dhe i zgjasin jetën institucioneve atavike që kjo mazhorancë vetë i ka sulmuar, siç është KLD-ja, duke i dhënë kompetenca të ndryshimit kushtetuese ja kanë hequr në emërimin i gjyqtarëve. Ndërkohë kërkon t'i zgjasë përkohshëm një kryeprokurori antikushtetues e antiligjor, të zgjedhur me 69 vota dhe t'i japë atij kompetenca që nuk i takojnë në rol për emërimin e prokurorëve të rinj. Zgjidhja që insiston në këtë rast opozita, është ngritja e KLP e KLGJ e në vazhdimësi e institucioneve të tjera të drejtësisë si SPAK e BKH. Aq më tepër, emërimet që vijnë nga magistratët e rinj nuk janë zgjidhja, pasi ata janë fare pak në numër dhe minimalisht duhet të kalojnë në një stazh 10-15 vjeçar që të arrijnë stadin për të plotësuar vendet vakante në sistemin e lartë të drejtësisë. Çdo ndërhyrje e këfillë, do të devijonte qëllimin e reformës dhe do theksonte akoma më shumë kapjen politike, tashmë evidente, që po i bëhet sistemit, nëpërmjet zbatimit të standardit të dyfishtë që po ndjek KPK në krasitjen që po realizon, ku kriteri politik dukshëm është themelori në vetingun e shumë reklamuar.

Miratimi i këtyre ndryshimeve a do të zhblokonte dot situatën e krijuar nga mungesa e institucion-



eve të reja të parashikuara nga reforma në drejtësi, pasi kërkon 84 vota, të cilat shumica socialiste, e vetme, nuk i ka?

Këto ndryshime janë thjeshtë një truk ligjor-politik dhe jo zgjidhje ligjore e aq me keq aspak të parashikuara në hapat e një reforme të miratuar unanimisht më 22 korrik.

Për më tepër, dukshëm këto ndryshime të propozuara nuk zgjidhin ngërçin e krijuar nga keqmenaxhimi politik i vetingut, por shojnë frikshëm emërimet e përgjehdhet politike brenda sistemit, përpos që shmanjin ngritjen e institucioneve që do progresonin reformën, siç janë KLP e KLGJ. Ka dy faktorë që i bëjnë jo funksionalë këto ndryshime. Faktori i parë, koha e përgatitjes së magistratëve e rinj, se paku fillimisht 3 vjeçare dhe koha e arritjes së karrierës së tyre për të qenë të mundshëm të jenë pjesë e rritjes në karrierë. Shtu këtu marrjen e kompetencave të padëgjura në asnjë pragraf kushtetues, të kësaj shkolle në përgjehdhe e emërimet. Faktori i dytë, është riaktivizimi i institucioneve të vjetra që reforma i nulifikon si KLD dhe zgjatja pa sens e qëndrimit në detyrë dhe dhënia e kompetencave antikushtetuese, një kryeprokurori që duhej tashmë të ishte larguar dhe të ishte zëvendësuar me një kryeprokuror konsensual, siç e parashikon Kushtetuta. Si të tilla këto propozime çojnë në deformime me pasojë të rënda për drejtësinë e tronditur.

Si e shikoni apelin e ndërkombëtarëve drejtuar opozitës për miratimin e këtyre ndryshimeve?
Apelet më të forta të ndërkombëtarëve përgjatë kësaj kohe, i përkasin



AKUZA

"Është kjo mazhorancë që ka pushkatuar reformën në drejtësi dhe që ka vrarë çdo shpresë e përpjekje për të ardhmen në këtë vend", - u shpreh kreu i departamentit për arsimin në PD.

nevojës për ngritjen me urgjencë të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë. Ata e dinë shumë mirë që ndryshimet e insistuar nga Rama vetëm se pengojnë dhe e shtojnë reformën drejt kalendrave greke, duke ndërthurur një barrikadë penguese për institucionet e reja të drejtësisë që duhet të ishin ngritur me kohë. Çdo gjë tjetër përtej këtyre parashtrimeve, është diplomaci normale ndërkombëtare. Muzikë e dëgjuar dhe e lodhur.

Pse sot Shqipëria është pa Gjykatë Kushtetuese dhe pa Gjykatë të Lartë? Kam parasysh këtu që Gjykata Kushtetuese është aktualisht jashtë loje. Drejt të njëjtit fat rrezikon të shkojë dhe Gjykata e Lartë, e cila tashmë funksionon me numër të kufizuar të anëtarëve të saj, ndërsa mungesa e Këshillit të lartë të Prokurorisë po mban pezull dhe Byronë Kombëtare të Hetimit dhe SPAK-un ose njësinë speciale antikorrupsion.

Vonesat në procedimin e hapave të reformës nga ana e mazhorancës dhe nxitimi për ta mbërthyer atë politikisht me keqpërdorimin e vetëingut, kanë sjellë këtë kolaps të rëndë institucionin.

Më e keqja është se e gjitha kjo situatë kaotike interpretohet si rastësore madje dhe si sukses, kur qartazi dëshmohej se mungesa e këtyre institucioneve, i shkon për shtat harbutërisë ligjore që ndjek si normë sjellje kjo mazhorancë. Mjafton të përmendim ligjin special për te-

atrën, lehtësisht i atakueshëm në Kushtetuese, por që nuk mund të ndodhë për shkakun e vetëm të mungesës së kësaj gjykatë.

Po kështu pengimi i SPAK dhe i BKH, nëpërmjet devijimit të KLP e KLGJ, krijon klimën e kushtet e përshatshme që qeveritarët të grabisin qetësisht, pa u trembur nga ndëshkimet, pasuritë kombëtare e të sheshtin interesat kombëtare. Siç renat e alarmit janë ndezur kudo në gjykatat e të gjitha niveleve, ku pesha e dosjeve të mbetura peng për këtë shkak, po zë poshtë drejtësinë e çunguar por veshët për t'i dëgjuar kanë kohë që janë mbyllur.

Ish-drejtori i Policisë së Shtetit Ahmet Prençi ka paralajmëruar se situata kriminale në Shqipëri është shumë delikate dhe e frikshme. Sipas tij është si një "bombë që i është hequr siguresa dhe pritet të shpërthejë". Ndërkohë Kreu i PD-së Lulzim Basha ka deklaruar se me fillimin e shtatorit do prezantohet projekti i amendimit të ligjit antimafia që do të bëjë të mundur që çdo klient i qeverisë të përfshirë në skema korruptive PPP-sh do t'i nënshtrohet formatit dhe, le të themi, kontroleve të ligjit antimafia. Konkretisht si mund të priten lidhjet e krimit me pushtetin?

Krimi në Shqipëri ka sot pushtetin absolut të kontrollit të politikës dhe nëpërmjet tij të jetës ekonomike e sociale në vend. Lidhjet dhe mar-

Thirrja pas shkarkimit të gjyqtarit të Durrësit Trezhnjeva, i cili nuk kaloi vetëingut

Ngërçi në KLGJ, Gjykata e Lartë thirrje gjyqtarëve për të kandiduar

Gjykata e Lartë i bën thirrje gjyqtarëve të Gjykatave të Apelit në rrethe që të aplikojnë për pozicionin e anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ). Thirrja e Gjykatës së Lartë vjen pas shkarkimit të gjyqtarit të Apelit të Durrësit, Besim Trezhnjeva, i cili nuk kaloi filtrat e vetëingut për shkak të burimeve të pajustificuara të pasurisë. Këshilli i Lartë Gjyqësor përbëhet nga 11 anëtarë, gjatë prej të cilëve zgjidhen nga gjyqtarët e të gjitha niveleve të pushtetit gjyqësor dhe pesë anëtarë i zgjedh Kuvendi, nga radhët e juristëve jogjyqtarë. Në qoftë se edhe pas thirrjes së dytë nuk paraqiten kandidatë nga shkallët e papërfaqësuara të gjyqësorit, zgjedhja e tyre bëhet me short nga radhët e gjyqtarëve që kanë kandiduar për vendin vakant. Çdo kandidat që përmbush kriteret për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit dhe kriteret për t'u



ngritur në detyrë ose për t'u transferuar në shkallët e papërfaqësuara të gjyqësorit, ka të drejtë të kandidojë për vendin vakant përkatës. Për këtë qëllim, Gjykata e Lartë, në referim të këtyre dispozitave ligjore rishpall thirrjen e dytë për paraqitjen e shprehjes së interesit për gjyqtarët e gjykatave të apelit jashtë Tiranës për të paraqi-

tur kandidaturën për t'u zgjedhur në pozicionin e anëtarit të KLGJ. Sipas përcaktimeve të mësipërme afati i shprehjes së interesit është 15 ditë nga dita e rishpalljes së thirrjes së dytë dhe përfundon me datë 6 shtator 2018. Gjyqtarët e interesuar duhet të paraqesin kërkesën dhe dokumentacionin sipas parashikimeve të nenit 10 të

ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" në Gjykatën e Lartë. Gjyqtarët e interesuar duhet të plotësojnë formularët: a) deklarata individuale e gjyqtarit që mbështet kandidimin; b) formulari i vetëdeklarimit, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; c) formulari për informacion mbi të afërmit e shkallës së dytë, ungi/emtë, nip/mbesë, gjysh/gjyshe, gjysmë vëlla/motër dhe të afërmit e shkallës së parë të bashkëshortit/bashkëjetesit, prindër, fëmijë dhe vëllezër/motra që ushtrojnë në mënyrë aktive profesionin e avokatit ose janë pronarë ose drejtues ekzekutivë në subjektet ekonomike, të cilat klasifikohen si tatimpagues të mëdhenj nga autoriteti tatimor.

PROTESTAT

"Betejat politike nuk do jenë thjeshtë e vetëm deklarative e denoncuese. Synimi i tyre në formë dhe përmbajtje, përfshirë dhe protestat masive, do jetë i fokusuar në arritjen e qëllimit që sot e kërkon pjesa dërmuese e shqiptarëve, të largimit të Ramës nga drejtimi i vendit", - theksoi Z. Boçi.

rëveshjet e paktet e hapura dhe të heshtura që Rama e enturazhi i tij ka me organizatat kriminale, janë jetike për pushtetin e tij dhe shpëputja e tyre nuk mund të arrihet nëpërmjet kësaj qeverisjeje. Kjo gjë hyn në rendin e gjërave të pamundura. Faktet e ditëve të fundit sikurse ato të denoncuar nga PD-ja, për ministrat e drejtues të lartë të implikuar direkt në trafikimin ndërkombëtar drogash e aktivitetit kriminal, dëshmojnë sa e thellë është simbioza krim-politike e majtë. Vetë qeverisja funksionon mbi norma e parimet mafioze të një organizate të

pastër e mirëorganizuar kriminale, misioni i së cilës mbetet prodhimi i parave nëpërmjet pushtetit dhe pjellja e pushtetit për mes këtyre parave. Propozimet e deklamuara nga Z.Basha janë një detajim i kuadrit ligjor dhe zgjerimin i profileve të krimit të organizuar, përfshi PPP-të korruptive si dhe fushëveprimin e ligjit antimafia që do të prekte jo vetëm ministrin e brendshëm, por dhe një radhë të gjatë pushtetarësh, përfshirë pse jo dhe Ramën, pasuria e të cilit sipas OSBE kalon 200 milionë eurot. Parashikohet të ketë rezistencë nga mazhoranca, sepse këta i tremben asaj që vjen më pas dhe për më tepër e dinë mirë se çfarë kanë gatuar. Propozimet dëshmojnë prioritet tona për ndëshkim ekzemplar të krimit dhe për një vend e rend të pastër nga krimi, një vend qytetarët e të cilit nuk duhet e nuk mund të ndërtojnë jetët e tyre nën diktatin e krimit, pavarësisht formës politike që ai ka sot.

PD gjatë këtyre muajve ka vijuar me denoncimin e aferave korruptive përfshi dhe koncesionet ku sipas demokratëve PPP janë akt i pastër korruptiv në Shqipëri". Realisht në ç'mënyrë po grabiten shqiptarët?

PPP-të po thithin e grabisin kontributet e pasuritë jetike të qytetarëve, duke i devijuar paratë e shumë viteve të ardhme të tyre, në

duart e klientëve specifikë të Ramës, për projekte që duken të domosdoshme, por që nuk ndjekin një progresion normal prioritar.

Të gjitha PPP-të me koston e tyre po varen si zinxhirë në qafën e brezave të tërë dhe po ngjijnë orekset makute të politikanëve të bërë njësh me bizneset fiktime dhe oligarke që pasurohen brenda natës me një firmë kryeministore. Për më tepër kostoja e tyre është marramendëse dhe zhdukim jo vetëm paratë e shumë brezave por dhe konkurrencën e ndershme dhe tregun e lirë. Këto do sjellin në vazhdimësi me pak para në Arsim, në kulturë, në art, në shëndetësi, duke goditur rëndë mirëqenien e normalitetin tërësor të njerëzve dhe duke penguar prosperitetin normal ekonomik të vendit.

Mijëra demonstrues kanë mbushur rrugët e Bukureshtit për të kërkuar dorëheqjen e qeverisë rumune të socialdemokratëve, por, a presim një skenar rumun edhe ne Shqipëri?!

Nuk është rasti i parë kur rumunët kanë qenë një hap para nesh, por njëkohësisht dhe një ogur i mirë për atë çka vjen tek ne. Kjo ka dhe ironinë pozitive brenda, sepse ne kemi shkaqe shumë më të mëdha se rumunët, por dhe "revoltën" e vogël për vonesën, në kohën e duhur, reaguese qytetare tek ne. E

rëndësishme është që kjo frymë revolte është ngritur dhe pret të shpërthejë.

Shqiptarëve u ka ardhur në majtë të hundës me shumë se rumunëve.

Groshët e vrimës së miut për Ramën po rriten me kalimin e ditëve.

Paralelisht me aksionin opozitar demokratë po përgatiten për zgjedhjet në parti, të cilët u shtynë në në vjeshtë për shkak të zhvillimeve politike. Kë do të prekin ndryshimet e reja në PD dhe çfarë synon PD për mes zgjedhjeve të reja?

Ndryshimet e reja do të prekin të gjithë hierarkinë drejtuese të partisë në përputhje me kërkesat e reja statutore. Kjo nënkupton një organizim qelizor që nis me seksionet dhe grupseksionet e vazhdon më tej në katet e larta të drejtimit.

Organizimi i ri synon dhënie të drejtësisë në vendimmarrës anëtarit më të thjeshtë dhe strukturave bazike të PD. Ndrërtimin e një kontributi kapilar dhe sigurimin e një demokracie të bre ndeshme e funksionale ku është e garantuar si vlerësimi ashtu dhe gjithsecilit sipas parametrevë të matshëm më së miri. Në këtë mënyrë synohet një organizatë funksionale, reale, fleksible e rezultative e aftë dhe e gatshme të marrë në dorë drejtimin e vendit.

Propozimet e Sipërmarrjes: Të hiqet TVSH për nënkontraktorët, të lehtësohet Kodi i Punës

Ornela Manjani

Lehtësitë për biznesin, paketa e dytë me propozime për qeverinë

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes dorëzon draftin e detajuar

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato, ka dorëzuar paketën e dytë me propozimet e bizneseve për qeverinë. Rekomandimet vijnë pas shqetësimeve të ngritura gjatë tryezave me përfaqësues të bizneseve dhe propozojnë ndryshime në procedurat doganore, tati-more, Kodin e Punës, etj. Konkretisht, sipërmarrjet kanë kërkuar rishikimin e ligjit për procedurat doganore, duke i unifikuar ato me procedurat tatimore, të cilat parashikojnë pagesën e detyrimit dhe jo penaltetit. Bizneset kërkojnë, gjithashtu, shtrirjen e inspektimit online në të gjitha fushat e inspektimit, si diçka që do të garantonte transparencë dhe niste konkurrencën në treg. Sa i takon Kodit të Punës, sipërmarrja ka raportuar problematika në zbatimin e disa akteve nënligjore. Ndaj ato kërkojnë rishikimin e neneve që përcaktojnë gjokat dhe rishikimin e masave të gjobave. Krahas tyre, kërkohej mundësia e vendosjes së një fleksibiliteti më të lartë në zbatimin e orëve minimale, orëve jashtë orarit dhe dhënies së pushimeve. Një tjetër ndryshim i kërkuar në Kodin e Punës është lehtësimi i bizneseve nga detyrimet e kontroleve mjekësore për punonjësit, përfshirë vendosjen e mjekut. Paketa përmban edhe disa propozime specifike për sektorë të ndryshëm. Kështu, kërkohet përjashtimi nga TVSH-ja i nënkontraktorëve. Ky propozim vjen nga industria fashone, bazuar mbi problematikën e krijuara, kur nënkontraktorët paguhen pa TVSH, për shkak se subjekti primar që i furnizon pret rimbursimin e TVSH për të bërë pjesën tjetër të pagesës. Gjithashtu, kërkohet fshirja e detyrimeve të prapambetura për qindra fermerë dhe agrobiznese të rezultuara nga një grant i dhënë nga qeveria e Japonisë në vitet 1999-2005. Ndërsa industria e riciklimit kërkon kufizimin e eksportit të mbetjeve plastike dhe letër, të cilat shërbejnë si lëndë të para për këtë industri, duke qenë se ndalohet aktualisht importi i tyre.

PUNËSIMI

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes ka organizuar tryeza sektoriale për rritjen e punësimit i ku një nga pikat kryesore ishte konsultanca e sipërmarrjes në hartimin e Planit Kombëtar për nx-



Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Sonila Qato

Tatimet, procedurat e reja

PROCEDURA TATIMORE

Një nga kërkesat e sipërmarrjes që punon nën regjimin e përpunimit aktiv (fason) është përjashtimi i nënkontraktorëve nga TVSH-ja. Subjektet primare që furnizojnë të tretët i paguajnë ata pa TVSH-në (d.m.th 20% më pak) me premtimin që TVSH-në do t'ia kalojnë kur të rimbursohen nga shteti. Si rrjedhojë, subjektet e vogla marrin më pak para dhe janë në varësi të kontraktorit kryesor. Subjektet që furnizojnë të tretët automatikisht duhet ta kalojnë pjesën e kontrollit, që të marrin rimbursimin e TVSH-së. Në këtë mënyrë nënkontraktori pret kontraktorin dhe ky i fundit pret qeverinë, duke krijuar kështu vonesa në pagesa që kanë vënë në vështirësi nënkontraktorët,



teksa kjo e ardhur e munguar është zë i fuqishëm i tyre.

ARGUMENTIM

Ky ligj, sikurse dihet, synon harmonizimin dhe përputhshmërinë e tij me dispozitat e Direktivës së Këshillit 2006/112 datë 28.11.2006, "Për Sistemin e përbashkët të TVSH-së", të konsoliduar. Ligji i ri për TVSH ka një ndryshim shumë të rëndësishëm për sektorin e regjimit të përpunimit aktiv (fason). Ky

ndryshim ka të bëjë me marrëdhëniet me nënkontraktorët. Ai konsiston në heqjen e statusit si "i përjashtuar nga TVSH" për nënkontraktorët, të cilët me këtë status nuk e faturonin TVSH për shërbimin dhe, gjithashtu, nuk rimbursonin TVSH për blerjet.

PROPOZIM

Në ligjin nr. 92/2014, dt 24/07/2014 "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar", në nenin 54 "Të tjera përjashtime nga TVSH-ja", të parashikohet: Kryerja nga nënkontraktorët e furnizimit të shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të destinuara për t'u riksportuar për personat e tatueshëm të autorizuar mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv, është furnizim i përjashtuar.

itjen e punësimit, mbi masat që marrin institucionet për të nxitur krijimin e vendeve të reja të punës. Pikat kryesore që dolën gjatë konsultimeve ishin identifikimi i grupeve që kanë vështirësi në integrimin në tregun e punës, mbështetur në moshën,

gjininë, nivelin arsimor, identifikimi i formave "horizontale" për gjenerimin e vendeve të punës nga sektori privat, në nivele sektoriale, ndërhyrje në kuadrin ligjor për sa i përket konkurrencës, ndërhyrje në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore etj., krijimi i katalogut të ndërmarrjeve që mbahet nga NQV, identifikimi i nevojave sektoriale për formim profesional, vënia në funksion të bordeve të shkollave profesionale me dy përfaqësues nga biznesi, njëri prej të cilëve dhe kryetar i saj, etj.

NDRYSHIMET

AGROBIZNES

Eliminim i detyrimeve të prapambetura

Detyrime të shumta të prapambetura për disa qindra fermerë e subjekte të agrobiznesit të rezultuara nga një grant i dhënë në mbështetje të fermerëve shqiptarë nga qeveria e Japonisë në vitet 1999-2005.

Argumentim

Hartimi i një ligji të veçantë, i cili të parashikojë për subjektet pasive për më shumë se 2 vite, fshirjen e detyrimit, i cili nuk ka asnjë mundësi mbledhjeje dhe regjistrimi i tyre në database-n e administratës shtetërore, me qellim mbylljen e detyruar të tyre.

Propozim

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes rekomandon rishikimin e ligjit nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" për fshirjen e detyrimeve të prapambetura për disa qindra fermerë e subjekte të agrobiznesit, subjekt i grantit në mbështetje të fermerëve shqiptarë nga qeveria e Japonisë në vitet 1999-2005.

KODI I PUNËS

Rishikim i disa neneve

Janë raportuar problematika sa i takon zbatimin të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore pasi krijon vështirësi dhe pengesa për zhvillimin e mëtejshëm të sipërmarrjes prodhuese.

Argumentim

Përmirësimi i vazhdueshëm i Kodit të Punës në përputhje me nevojat bashkëkohore të një tregu dinamik, është i nevojshëm për lehtësimin e klimës së biznesit dhe optimizimin e kapacitetit prodhues të sipërmarrjes.

Propozim

Rishikimi i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë LIGJ Nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar në disa nene të tij, për shembull: Rishikimi i 58 neneve që përcaktojnë gjoka për bizneset; Rishikim i masave të gjobave; (Nisin nga 20 rroga mujore deri në 250 rroga mujore); Fleksibilitet më i lartë në zbatimin e orëve minimale, orëve jashtë orarit, dhënies së pushimeve; Lehtësimi i bizneseve nga detyrimet e kontroleve mjekësore për punonjësit, përfshirë vendosjen e mjekut.

LEJE, LICENSA E AUTORIZIME

Publikimi në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve

Nënvizohet detyrimi për zbatimin e dispozitave ligjore dhe publikimin në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve të vendimeve përkatëse. Nevoja për vëmendje vjen nisur nga një kërkesë e kryer më datë 19/06/2017 nga subjekti X, i cili ka paraqitur kërkesën për pajisjen me licencën "Për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me karburant, për konsum, të anijeve në porte dhe në rada", dhe nuk ka pasur mundësinë e leximit në sistemin online të kësaj kërkeje.

Argumentim

Bazuar në nenin 14, të ligjit Nr. 10081, datë 23/02/2009 "Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në të cilin parashikohet se "çdo kërkesë për pajisjen me licencë/leje të caktuar apo për bërjen e ndryshimeve në të dhe çdo licencë/leje të dhënë e të vlefshme publikohet në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve, i cili është lirishit i aksesueshëm nga publiku, me përjashtim të të dhënave, të cilat janë me akses të kufizuar apo të ndaluar, sipas legjislacionit në fuqi."

Propozim

Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes rekomandon që në cilësinë e institucionit tjetër përgjegjës për vendimmarrjen në fushën e shërbimeve portuale, Ministria e Infrastrukturas dhe Energjetikës duhet të publikojë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve vendimet në lidhje me këto licencë.

Përfituesit të dorëzojnë shtatë dokumente për të marrë 20 % të vlerës së pronës në para

Dosjet e viteve 2013-2014, pronarët që marrin paratë

Pronarët që janë kundër vendimit të ATP-së 1 javë kohë për ankimim

Ornela Manjani

Pronarët që janë njohur me vlerësimet financiare të viteve 2013-2014 kanë të drejtë që brenda një jave të paraqesin ankimin në Gjykatën Administrative, në rast se nuk janë dakord me vlerësimin që ka dhënë Agjencia e Trajtitimit të Pronave. Lista përmban 27 emra dhe janë të fundit në radhën e vendimeve të ndërmarrura nga ATP, vetëm një muaj para se institucionet e pronave të bashkohen në një çati. Në rast se pronarët që nuk janë dakord me vlerësimin në ankimin brenda këtij afati, vendimi kthehet në titull ekzekutiv dhe ata s'mund të ndjekin më asnjë rrugë ligjore për korrigjimin e vendimit. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuar, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikën në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje.

ANIKIMIMI

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP shtatë dokumente për të marrë 20 % të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtitimit të Pronave sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në Agjencinë e Pronave për të dorëzuar kërkesën për kompensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablejtes (nëse është njohur në vendim), dëshmi trashëgimie, prokurë, deklaratë noteriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e llogarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese. 8 pronarë që kanë dorëzuar dokumentet për kthimin a kompensimin e pronës në vitet 2013-2014, nuk do të mund të përfitojnë nga fondi i këtij viti, pasi dokumentet e tyre nuk janë të rregullta. Pas vlerësimit që ka bërë Agjencia e Trajtitimit të Pronave me ligjin e ri, për secilin prej tyre është specifikuar dhe mangësia në dosje,



por kjo nuk i ka mbyllur shpresat, pasi këtyre pronarëve u është lënë një periudhë 6-mujore për të bërë plotësimin e nevojshëm, e më pas të dalë llogaritja për kompensimin. "Subjektet e interesuara që evidentojnë të meta

apo pasaktësi në këtë regjistër mund të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin fi-

nciar të vendimit të kompensimit, brenda një afati prej 6 muajsh", thekson ATP-ja. Ndërkohë me kalimin e afatit ligjor 6-mujor për depozitimin e dokumentacionit shtesë të nevojshëm, Agjencia e Trajtitimit të Pronës do të zbatojë parashikimet ligjore të përcaktuara për këtë kategori vendimesh përfundimtare për kompensim. Nga 27 kërkesa të depozituara 4 vjet më parë, 2 vendime janë ezauruar, 19 kanë një vlerë financiare për t'u kompensuar, ndërsa 8 të tjerë nuk kanë dorëzuar dokumentet e plota. Konkretisht, në dosjet për kërkesa kompensimi të tokave e trojeve në të gjithë vendin, është hartuar dhe lista përkatëse e mangësive.

Nr. Rendor	Nr/ Dosje	Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	VLERESIMI
1	504	Tiranë	Halit Cara	473,661
2	447	Gjrokastër	Vullnet Kallajxhi	502,704
3	54	Korçë	IVANI FABERI	35,490
4	255	Shkodër	Carla Meschini	51,336,600
5	158	Berat	Ilija Therecka	
6	380	Shkodër	Lufti Bala	485,127
7	533	Tiranë	SHADIJE LIÇI	
8	161	Elbasan	ERVIN GJATA	-1,748,067
9	249	Korçë	Jashar Hysenbegasi, Sabri Hysenbegasi	
10	750	Shkodër	Fatbardhe Hefovia	3,659,730
11	610	Tiranë	AV.MAKSIM GJOKUTAJ	-2,978,250
12	171	Shkodër	Mark Dedushi	793,800
13	1474	Shkodër	Mark Kol Doda	585,000
14	1723	Tiranë	LORETA DERVISHI	11,719,575
15	531	Lezhë	Fran Tanushi	690,780
16	245	Tiranë	SELMAN HYSENAGOLLI	
17	533	Tiranë	ALI ZELA	
18	598	Tiranë	PETRIT SHEHU	2,417,210
19	137	Berat	Destimona Tartari (Zhiti)	6,699,000
20	161	Elbasan	Fete Dishaj	314,318
21	87	Gjrokastër	Figjiri Fagu	
22	384	Tiranë	RUKIE JARECI	633,318
23	59	Elbasan	KUJTIM GJEVORRI	
24	1-Sep	Kukës	Avni Rexh Petku	
25	417	Vlorë	Lumturi Papingji	398,000
26	702	Vlorë	Mimin Mustafaraj	13,708,800
27	1057	Kukës	Tahir Imer Cenaj	-29,951,513

SHKURT

Ulja e humbjeve në rrjet, OSHEE parashikon minimizim me 2% dhe 1.9 mld më shumë fitim

Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike parashikon ta mbyllë këtë vit me një fitim prej 2.9 miliardë lekësh, apo me një rritje prej 1.9 miliardë lekësh me shumë se vitit 2017. Në planin e investimeve të OSHEE për periudhën 2018-2022, detajohet se fitimet në rrjet për vitin aktual, mbështeten tek rritja e tarifës së OST me 0.1 lekë/kwh; rritja e tarifës së KESH me 0.05 lekë/kwh dhe rritja e tarifës së HEC-ëve private me reth 1 lekë/kwh. Nga ana tjetër, humbjet në rrjet janë parashikuar të ulen me 2% gjatë këtij viti, duke arritur nivelin më të ulët historik prej 24%. Ndërsa të ardhurat nga kmatvonesat pritet të jenë në të njëjtin nivel me vitin 2017. Niveli i arkëtimit për vitin 2018 është parashikuar 95% në përputhje me targetet e planit të rimëkëmbjes së sektorit. Ndërsa sa i takon investimeve, 8.7 miliardë lekë nga fondet e OSHEE do të shkojnë për rrjetin e shpërndarjes dhe 2 miliardë lekë do të investohen nga fondet e kredisë së akorduara nga Banka Botërore. Sipas të dhënave zyrtare të OSHEE për gjysmën e parë të vitit, niveli i humbjeve në rrjet u regjistrua në 25.4%, ndërsa arkëtimet u rritën me 1.5 miliardë lekë krahasuar me 2017-in.

Dëmtim rrjeti nga privati në Orikum, Himarë e Tiranë, OSHEE plan masash

Tri raste të mungesës së energjisë elektrike të shkaktuara nga palët e treta janë regjistruar gjatë 24 orëve të fundit në zonën e Orikumit, Himarës dhe Tiranës. Sipas Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, dhe në orën 16:45 u dëmtua fideri nr.2 në Nënstacionin Himara 1 për shkak të këputjes së përcjellësit në pjesën e një degëzimi të një subjekti privat si dhe nga moti i keq me shtrëngata e shi. Si rrjedhojë, mbeti pa energji elektrike një pjesë e Vunoit deri në Potam. Ndërsa, dhe sipas OSHEE-së, u dëmtuar rrjeti TM i fiderit nr.3, Nënstacioni Radhimë nga një firmë private ndërtimi, duke lënë pa energji elektrike qytetin e Orikumit. Po ashtu, një tjetër rast është shënuar po ditën e sotme në Tiranë, ku bëhet e ditur se është dëmtuar fideri nr.28, Nënstacioni Kashar nga ana e Ujësjellësit. Si rezultat i dëmtimit, një pjesë e zonës së Kamzës ka mbetur pa energji elektrike. Grupet e punës së OSHEE kanë kryer ndërhyrjet e nevojshme duke rikthyer energjinë elektrike brenda një kohe të shkurtër.

LEZHE-Një aksident i rëndë ka ndodhur gjatë mesnatës të së martës në aksin rrugor Shkodër-Lezhë, ku kanë humbur jetën dy të rinj. Mësohet se aksidenti ka ndodhur në fshatin Dajç, në kufirin ndarës mes Shkodrës dhe Lezhës. Bëhet me dije se viktimat janë 25-vjeçari Robert Ejlli dhe 32-vjeçari Gentian Toma, kushërinj me njëri-tjetrin. Dy të rinjtë udhëtonin me një makinë tip "Benz" me targa AA 929 FF e cila është përplasur me një kamion tip "IFA" me targa LE 3364 A. Mjeti

Shkak i aksidentit dyshohet shpejtësia tej normave të lejuara

Makina përplasat me kamionin në Lezhë, humbin jetën dy kushërinjtë

"Benz" i dy të rinjve ka goditur nga mbrapa kamionin dhe shkak dyshohet shpejtësia tej normave të lejuara. Ndërsa drejtuesi i kamionit, 19-vjeçari me iniciale E.B. fatmirësisht shpëtoi pa lëndime të rënda, edhe pse u godit nga "Benz" dhe përfundoi disa metra jashtë të rrugës. "Më datë 22.08.2018, rreth orës 01:40, në superstradën

Lezhë - Shkodër, në vendin e quajtur "Ura e Dajçit", është marrë njoftim se ka ndodhur një aksident automobilistik, ku mjeti tip "Benz" me targa AA 929 FF me drejtues shtetasin G.T. 32 vjeç, banues në Mabë - Lezhë, ka goditur nga mbrapa mjetin tip "IFA" me targa LE 3364 A me drejtues shtetasin E.B. 19 vjeç, banues në Lezhë. Për pa-

sojë kanë humbur jetën drejtuesi i mjetit "Benz" shtetasi G.T. dhe pasagjeri po në këtë mjet shtetasi R.E. 25 vjeç, banues në Mabë - Lezhë", thuhet në njoftimin e policisë. Grupi hetimor nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, vazhdojnë hetimet për zbardhjen e plotë të shkaqeve të aksidentit.



Gentian Toma



Robert Ejlli

Kush është 39-vjeçari i njohur ndryshe si "Tenxherja" e kokainës nga Librazhdi

Ina Allkanjari


Rreth 1 milionë euro llogari bankare janë sekuestruar nga policia në kuadër të operacionit "Forca e ligjit". Sipas Policisë së Shtetit dyshohet që paratë të jenë përfituar nga aktiviteti kriminal i trafikut të drogës në Greqi. Bëhet me dije se personit, të cilit i është sekuestruar shuma e parave, e cila dyshohet se është përfituar nga trafiku i drogës është Roland Shëmbitrasi me origjinë nga Korça dhe banim në Librazhd.

Shëmbitrasi, u ekzekutua në moshën 39-vjeçare më 8 tetor të vitit 2017 në lagjen "Glyfada" në Athinë. Ndërsa ditën e djeshme policia njoftoi se familjes së tij i janë sekuestruar llogaritë bankare. Në total deklaroi policia janë sekuestruar 111.402.609 lekë, të cilat dyshohet se janë produkt i veprimtarisë kriminale të shtetasit Roland Shëmbitrasi në fushën e "Trafikimit të lëndëve narkotike", në Greqi. Sipas burimeve zyrtare, në kuadër të operacionit "Forca e ligjit", në vijim të punës për gjurmimin, evidentimin dhe sekuestrimin e aseteve dhe llogarive bankare që dyshohet se rrjedhin apo janë përfituar nga veprimtari kriminale, pas procedimit nr.443 të vitit 2017, Policia e Shtetit bazuar edhe në shkëmbimin e informacioneve me partnerët, referoi materialet e para në prokurori për fillimin e pro-

U vra në Greqi në 2017, "Forca e ligjit" i sekuestron 1 milion euro pasuri

Policia: Dyshohet se Roland Shëmbitrasi i ka përfituar paratë nga trafiku i drogës

cedimit pasuror për shtetasin Roland Shëmbitrasi. Në vijim u regjistrua edhe procedimi pasuror me nr.8, i vitit 2018. Departamenti i Policisë Kriminale, Drejtoria Hetimore Qendrore, u informua nga agjenci ligjzbatuese për veprimtarinë e kundërligjshme të tij. Kështu në gusht 2018 u bë ekzekutimi pranë një banke të nivelit të dytë, i vendimit për vendosjen e sekuestros së llogarive bankare në emër të shtetasve: Kasëm Shëmbitrasi, Vera Shëmbitrasi dhe Albana Shëmbitrasi, në vlerën 42.000.000 lekë. Pranë një tjetër banke të nivelit të dytë, u bë ekzekutimi i vendimit të gjykatës për vendosjen e sekuestros së llogarive bankare në emër të shtetasve: Kasëm Shëmbitrasi në shumën 17.033.337 lekë; Bernard Shëmbitrasi



Roland Shëmbitrasi

në shumën 924.922 lekë; Roland Shëmbitrasi në shumën 51.444.350 lekë. Në total u sekuestrua shuma 111.402.609 lekë. Hetimet vazhdojnë për të verifikuar pasuri të luajtshme apo të paluajtshme si dhe llogari bankare të dyshuara me prejardhje kriminale.

EKZEKUTIMI

Roland Shëmbitrasi me origjinë nga Korça prej

vitesh ishte rezident në Greqi. Ai ishte i martuar dhe babai i dy vajzave të mitura. 39-vjeçari u ekzekutua në lokalitë e natës Joy Bar nga persona të paidentifikuar. I plagosur gjatë atentatit mbeti edhe një shqiptar tjetër i quajtur Gjergji Kapaj. Hetuesit grekë thanë atë kohë se ngjarja kishte lidhje me trafikun e drogës dhe dyshohet për larje hespesh

TRAFIKU I DROGËS

Shëmbitrasi ishte një nga eksponentët e rëndësishëm të trafikut të kokainës në lokalitë e natës në Greqi dhe një prej me nofkën "Tenxherja" Ai është bashkëpronar edhe i tri lokaleve të tjera.

mes bandash.

Shëmbitrasi ishte një nga eksponentët e rëndësishëm të trafikut të kokainës në lokalitë e natës në Greqi dhe një prej me nofkën "Tenxherja"

Ai është bashkëpronar edhe i tre lokaleve të tjera, dy prej të cilave janë luksoze dhe ndodhen në lagjen "Kaliithea" të Athinës. Në këto lokale nate shkojnë

regullisht këngëtarë të njohur grekë. Në vitin 2012, Shëmbitrasi ishte arrestuar nga policia pasi kishte punësuar një ekip prej 10 personash që shpërndanin kokainë me motorë tek klientët VIP të 39-vjeçarit. Ai ka marrë nofkën "Tenxherja" për shkak se një prej përpunimim që i bënte kokainës. Në fund, ai nxirte një produkt të pastër për klientët e tij. Për këtë arsye, Roland Shëmbitrasi ishte edhe trafikanti më i shtrenjtë në Athinë, pasi 1 gram kokainë e shite për 100 euro. Ai kishte një klientelë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e tyre i përkasin botës së "showbiz" në Athinë dhe janë emra mjaft të njohur. Përveç se janë konsumatorë, shumë prej tyre performojnë në lokalitë e natës ku ishte bashkëpronar edhe Shëmbitrasi.

TIRANË-Zjarret në çerdhen nr. 14 dhe nr. 16 në Tiranë, duket se kanë qenë të qëllimshme. Hetimet para-prake nga ekspertët zjarri kanë nxjerrë se zjarret janë vendosur nga individë që kanë hyrë në mjediset e tyre, nga dritaret. Pas këtij përfundimi, policia ka nisur hetimet. Burime nga Policia e Tiranës thanë se në rastin e çerdhës nr. "Ali Demi" është gjetur tubi i gazit i prerë. Ndërsa në rastin e çerdhës 16 në dhomën e fjetjes

së fëmijëve në disa shtretër me largësi 2-3 m nga njeri-tjetri janë gjetur vatra zjarri. Shërbimi zjarri në Tiranë, në një raport ka shpjeguar se në rastin e zjarrvënies në çerdhen nr.14, autorët nëpërmjet një shkalle druri kanë thyer xhamin e dritares së ambientit të gatimit të çerdhës dhe kanë tentuar t'i vënë zjarrin. Teksa kanë dështuar në këtë tentativë, dera është hapur me forcë dhe autori ka dëmtuar tubin përçellës të gazit të njerës prej bombolave duke bërë që ambienti të mbushet

Zbardhet mekanizmi, ja si hynë autorët brenda dhe i vunë flakën

Zjarret në dy çerdhet e Tiranës, policia: Kanë qenë të qëllimshme

me gaz. Pasi ajri u ngop me gaz ka ndodhur shpërtimi që shkaktoi vetëm dëme materiale. Edhe zjarrin e së martës në çerdhen nr. 16 në rrugën "Nikolla Tupe" megjithëse policia në krye të herës e quajti aksidental, ekspertët zjar-

rrikës e konsiderojnë të qëllimshëm. Në momentin kur çerdhja u përfshi nga flakët njëra nga dritaret e saj ka qenë e hapur, nga ku dyshohet se ka hyrë autori i zjarrvënies. Në total në çerdhe pati 4 vatra zjarri në distancë të largët nga

njëra-tjetra. Një prej vatrave të zjarrit ka qenë në frigorifer, i cili nuk është djegur plotësisht. Ekspertët shpjegojnë se në rast të një zjarri aksidental vatra është vetëm një dhe automatik bie, gjë që në këtë rast nuk ka ndodhur. Po ashtu në

raste aksidentale frigoriferi digjet nga zona e motorit dhe zjarri depërton lart, ndërsa në këtë rast zjarri ka nisur nga lart dhe pajisja është djegur pjesërisht. Dyshimi për zjarrvënien të qëllimshme forcohet edhe më tej kur në dhomën e fjetjes së çerdhës është djegur edhe një shtret i cili është në distancë disa metra nga frigoriferi. Për të dy rastet e zjarrit në çerdhe materialet janë referuar në prokurori për zjarrvënien të qëllimshme dhe po vijojnë hetimet për zbulimin e autorëve.

SIGURIMI VULLNETAR PËRFITIMET

Kategoritë që mund të aplikojnë për sigurim vullnetar. Kufijtë e pagesës dhe tarifat mujore

Voltiza Duro

Pas përcaktimit të masës së pensionit, jo pak të moshuar kanë pakënaqësi në lidhje me pagesën që iu takon në bazë të viteve të punës. Por pensionistët që nuk i kanë plotësuar vitet e përcaktuara të punës me kontribute për të marrë pension apo masë më të lartë të tij mund të aplikojnë për sigurimin vullnetar. "Gazeta Shqiptare" publikon sot kushtet që duhet të përmbushin të interesuarit për këtë lloj sigurimi; ku në skemë përfshihen shtetasit shqiptarë që jetojnë në Shqipëri si dhe shqiptarët që jetojnë jashtë vendit. Sipas Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në skemën e sigurimit vullnetar përfshihen të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe akoma nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sigurimit të detyruar; ata që për një kohë dhe shkaqe të caktuara nuk mund të sigurohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm; si dhe personat që janë të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm dhe kërkojnë që nëpërmjet sigurimit vullnetar të rrisin të ardhurat e tyre. ISSH bën me dije se edhe personat që nuk janë pjesëmarrës në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi ose në rastet kur individit i interesuar ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri në datën që ka lënë shtetësinë shqiptare.

"Personi që ka paguar kontribut për sigurim vullnetar, pasi plotëson kushtet e përcaktuara në ligjin nr. 7703, është përfitimtar, sipas rastit, i pensionit të plotë të pleqërisë; pensionit të pjeshëm të pleqërisë; pensionit të reduktuar të pleqërisë; pensionit të invaliditetit; pensionit të pjeshëm të invaliditetit", - thekson ISSH.

Ndërkaq në sigurimin vullnetar, sipas ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", bën pjesë edhe pensioni familjar. Kontributi vullnetar llogaritet në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale të caktuar nga Këshilli i Ministrave dhe paguhet nga personi i siguruar në shumën dhe afatin e përcaktuar në kontratën e sigurimit vullnetar. Nëpërmjet sigurimit vullnetar mbulo-

ISSH: Pensionet e pleqërisë, si të merrni më shumë të ardhura

"Zbardhen zbritjet që mund të fitoni nga parapagimet"



hen katër fusha të kësaj skeme që janë: sigurim vullnetar për vitin korent; sigurim vullnetar për periudha të kaluara; sigurim vullnetar për më shumë të ardhura si dhe sigurim vullnetar për degët e tjera të sigurimit. Ndërkohë pensioni i plotë i pleqërisë përfitohet me 36 vite e 4 muaj punë të siguruar, ndërsa pensioni i pjeshëm kërkon minimalisht 15 vite pune me sigurime. Për të përfitur pension nga shteti shqiptar, emigrantët duhet të paguan një pagësë kontributi prej 5184 lekësh në muaj. "Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje: 6% mbi shumën për një pagësë vjetore; 3% mbi shumën për një pagësë 6 mujore; dhe 1.5% mbi shumën për një pagësë 3 mujore. Ju mund të siguroheni edhe për vitet e kaluara dhe mund të futeni në këtë skemë pa qenë të siguruar më parë. Kontributi për të kaluarën dhe të tashmen, t'ju sigurojmë të ardhmen", - bën thirrje Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Por nëpërmjet sigurimit vullnetar, mund të përfitojnë jo

vetëm emigrantët shqiptarë, por të gjithë qytetarët që jetojnë në Shqipëri e dëshirojnë të kenë një masë pensioni më të lartë se ai që është paracaktuar më parë. Për të rritur masën e pensionit të moshuarit mund edhe të bëjnë paraprakisht një kërkesë në portalin qeveritar e-albania si dhe të dorëzojnë dokumentacionin e plotë që kërkohet në këto raste pakënaqësish mbi pagesën.

SIGURIM VULLNETAR PËR VITIN KORENT

Instituti i Sigurimeve Shoqërore bën me dije se masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurimin vullnetar për vitin korent nga personi i interesuar, është e barabartë me masën që paguhet për degën e pensioneve, sipas pagës minimale të miratuar në periudhën kur bëhet pagesa. "Kuota mujore e sigurimit vullnetar për vitin 2017 është 5 184 lekë, që i korrespondon pagës minimale mujore: 24 000 lekë x 21.6%. Për pagesat paradhënie, aplikohen zbritje në varësi të kohës kur kryhet pagesa. Kështu,

6%

ZBRITJE PARAPAGESË 1 VIT

"Nëse do të parapaguani në fillim të periudhave do të ketë zbritje 6% mbi shumën për një pagësë vjetore", - bën me dije Instituti i Sigurimeve Shoqërore në faqen e tij zyrtare.

PERIUDHAT E KALUARA

Sigurimin vullnetar për periudhat e kaluara mund ta paguanjë të gjithë shtetasit shqiptarë që:

- ◆ Kanë mbushur moshën 18 vjeç
- ◆ Që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar
- ◆ Shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pas univesitare është me pagesë.
- ◆ Ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluar nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë.
- ◆ Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa.
- ◆ Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar, por në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

nëse do të parapaguani për vitin në vijim në fillim të periudhave, do të ketë zbritje: - 6% mbi shumën për një pagësë vjetore (me kusht që pagesat të realizohen brenda muajit janar); - 3% mbi shumën për një pagësë 6-mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 6-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar); - 1.5% mbi shumën për një pagësë 3 mujore (me kusht që pagesat të realizohen përpara fillimit të periudhës 3-mujore, që do të mbulohet me sigurim vullnetar)", - theksohet në faqen zyrtare të ISSH-së. Gjithsesi pagesat e vitit korent mund të bëhen edhe me shumëfishin e kuotës minimale mujore, 5 184 lekë, deri në kufi të pagës maksimale.

SIGURIM VULLNETAR PËR MË SHUMË TË ARDHURA

Sigurim vullnetar për më shumë të ardhura mund të paguanjë të gjithë personat ekonomikisht aktivë të vetëpunësuar; të punësuar dhe punëdhënësit, të cilët duhet të jenë të siguruar si të tillë në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shën-

detësore. Ky sigurim bëhet vetëm për vitin korent në kufijtë e pagave minimale dhe maksimale, 24 000 dhe 105 850 lekë (qytetari ka të drejtë të zgjedhë një pagë brenda këtij kufiri). ISSH bën me dije se personat e vetëpunësuar sigurohen me pagë minimale mujore 24 000 lekë e mbi këtë pagë çdo person ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e pagës maksimale 105 850 lekë. Ndërkohë punëmarësit që sigurohen në bazë të kontratës të nënshkruar me punëdhënësin, kanë të drejtë të sigurohen vullnetarisht për më shumë të ardhura mbi pagën që ata marrin deri në nivelin e pagës maksimale 105 850 lekë. Çdo punëdhënësi që sigurohet në nivelin e pagës maksimale ka të drejtë të sigurohet vullnetarisht deri në kufirin e kësaj pagë, ndërsa çdo kontribues vullnetar për vitin korent ka të drejtë të sigurohet për më shumë të ardhura.

SIGURIM VULLNETAR PËR PERIUDHA TË KALUARA

Sigurimin vullnetar për pe-

riudhat e kaluara mund ta paguanjë të gjithë shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe që nuk iu ka lindur e drejta për ndonjë përfitim nga skema e sistemit të detyruar si dhe shtetasit shqiptarë meshkuj për periudhën e studimeve universitare, pasi periudha pas univesitare është me pagesë. Ndërkohë ky sigurim për periudhat e kaluara mund të bëhet edhe nga shtetasit shqiptarë që kanë periudha të pambuluar nga sistemi i sigurimit të detyrueshëm dhe dëshirojnë t'i plotësojnë ato nëpërmjet sigurimit vullnetar si dhe personat që kanë lënë shtetësinë. Masa e kontributit që duhet të paguhet për sigurim vullnetar nga personi i interesuar për mbulimin e periudhave të kaluara përcaktohet nga koha kur bëhet pagesa. Pagesa aktuale për të mbuluar periudha të kaluara, bëhet vetëm në kuotën minimale dhe është 5 184 lekë për një muaj sigurim vullnetar por në këto pagesa nuk aplikohen zbritje.

REPUBLIKA E SHQIPËRIE
Zyra përmbartimore "Best 2018"

SHPLLJE ANKANDI

Më datë 17 shtator 2018 nga ora 08.00-ora.16.00 tek kjo zyrë përmbartimore do zhvillohet ankandi për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8516, Plazhi, Durrës. Truali që ka sipërfaqen prej 600 m² kufizohet sipas një marrëveshje sipërmarrje.

Prona është e vëllëzërve, Z.Arben e Z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 48735000 lek.

Cmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditës.

Ofertuesit duhet të kenë depozituar në llogarinë e zyrës përmbartimore 10% të çmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000

E-mail: best.2010@permbartures.al, web: www.permbartures.al

EPSPA SHOQERIA PËRMBARTUESE PRIVATE "E.P.S.A"

SHPK NJEFITON SHPLLJEN E ANKANDIT PËR :

1- "Pyll + Kullote" me sip. 280.000 m², Nr. hipotekor 168 date 29.05.2012, ZK 3028, e ndodhur në Porç, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 3.360.224 Euro . Ankandi zhvillohet datë 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr."1, Qemali", Pall."Fratri", K.6.Tirane.

2- "Pyll + Kullote" me sip. 95.000 m², Nr. hipotekor 66 date 25.03.2009, ZK 3028, e ndodhur në Porç, Vlorë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të Banka Raiffeisen sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 1.740.076 Euro . Ankandi zhvillohet date 07.09.2018 ora 16.00 në adresën Rr."1, Qemali", Pall."Fratri", K.6.Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni në tel. 04 2262711 ose në www.epspa.al

SHPLLJE ANKANDI

Zyra Përmartimore "E.G Bailiff Service" me përmbartes Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.09.2018 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i III për shitjen e pasurisë të paluajshme Truali me sipërfaqe 24.405,50 m² e ndodhur në rrugën "Ali Shërqeti", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, VOLUMI.20, Faqes.6, në pronësi të Shoqërisë BAU- CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 307.509 (Treqind e shtatë mijë e pesëqind e nëntë) EURO.

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Mjeku popullor: Shkaktarët kryesorë, çrregullimet në mekanizmin e rritjes së flokëve

Ylli Merja: Si të trajtoni rënien e flokut me bimë mjekësore

“Efektet e mrekullueshme të vajit të bajames”

Voltiza Duro

Flokët rriten 6-10 cm në vit tek çdo njeri, megjithëse kjo gjatësi ndryshon në individë të ndryshëm, pra mund të jetë më shumë ose më pak. Cikli i rritjes së flokëve ndahet në disa faza të ndryshme, e është i ndryshëm nga cikli i rritjes së flokut në pjesë të tjera të trupit. Faza e parë e rritjes së flokëve është ajo e daljes nga folikula (rrënja e fijos) deri në sipërfaqe dhe rritja e tij, periudhë që zgjat deri në 7 vjet. Pas këtij cikli fillon të dalë një fije tjetër në këtë folikul dhe kështu e shtyn fijen e parë të fillojë të shpëputet dhe të bjerë, duke dalë fija e re. Ky është një proces normal që ndodh çdo ditë tek çdo njeri. Për shkak se çdo fije ka një ditë “lindjeje” të ndryshme nga tjetra, ne kemi gjithmonë flokë dhe megjithëse flokët bien ka fije shumëvjeçare që kanë ditë të ndryshme rënieje.

ÇRREGULLIMET

Si çdo proces tjetër në organizëm edhe rritja e flokëve varet nga një mekanizëm në zinxhir. Nëse ç'ekuilibrohen këto mekanizma, atëherë flokët fillojnë të bien me shumicë dhe nuk dalin të reja. Ka shumë faktorë që ndikojnë në prishjen e këtij mekanizmi të krijimit të flokëve të reja. Mënyra e të ushqyerit është shumë e rëndësishme e nëse keni mbajtur ndonjëherë dietë, ose nëse ka qëlluar një periudhë që keni qëndruar shumë kohë pa ngrënë, apo nuk I keni konsumuar të gjitha vaktet, flokët fillojnë të dobësohen. Pra, nuk kanë më fortësinë, elasticitetin dhe trashësinë e duhur, ndërkohë që fillojnë të bien sidomos në pjesën e sipërme të kokës me shumicë.

FAKTORËT

Çrregullimet hormonale janë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në rënien e flokëve, veçanërisht problemet me gjëndrat tiroide. Gjatë pubertetit, shtatzënisë apo në menopauzë që ka çrregullime hormonale të mëdha, ka rënie të flokëve, por pasi kalojnë këto periudha flokët fillojnë rritjen normale. Në shumicën e rasteve në këto periudha nuk ka nevojë për mjekime për ti rikthyer flokët në normalitet. Në raste shumë të rralla që rënia e flokëve është



Mjeku popullor, Ylli Merja

të në të gjithë sipërfaqen e kokës, atëherë mund të jetë çrregullim hormonal, ose problem gjenetik, ku duhen kontrolluar të gjitha vitaminat, mineralet dhe hormonet në organizëm. Infeksionet ose sëmundjet e lëkurës shkaktojnë rënie të flokëve, gjithashtu, por vetëm në vende të lokalizuara. Ky është një problem që kurohet lehtësisht, madje edhe në kushte shtëpie. Sëmundjet e lëkurës si ekzema apo psori-

asis ndikojnë në rënien e flokëve, gjithashtu, sepse shkaktojnë irritime në lëkurë. Për këto lloj sëmundjesh nuk ka kurë por mund të përdorni kremra zbutës që të mbajnë nën kontroll lëkurën e kokës dhe kështu nuk do të ndikohet rritja e flokëve. Stresi çrregullon shumë mekanizma në organizëm, dhe një prej tyre është edhe procesi i rritjes së flokëve. Gjëja më e mirë në këtë rast për të arritur një balancë në gjithë organizmin do të ishte të mundoheni të ulni nivelin e stresit duke mos konsumuar kafe, apo produkte me kafeinë, duke bërë një shtetje në ajër të pastër si dhe mund të konsumoni çaj me kamomil dhe rozmarinë. Në këtë situatë nuk keni



Për të ndihmuar në forcimin e rrënjës së flokut përdoret çaji kundër rënies së flokut, i cili përmban gjethe e rrënjë hithre, rozmarinë, bisht kali etj. Ky çaj ushqen rrënjën e flokut e ndihmon në daljen e flokëve të reja. Pasi lahen flokët me shampo normalisht, shpëlahen me çajin, dhe jo me ujë të pastër. Çaji qëndron në gjithë flokun duke ndikuar gjatë gjithë kohës në formimin e tij.



Mënyra e të ushqyerit është shumë e rëndësishme e nëse keni mbajtur ndonjëherë dietë, ose nëse ka qëlluar një periudhë që keni qëndruar shumë kohë pa ngrënë, apo nuk I keni konsumuar të gjitha vaktet, flokët fillojnë të dobësohen. Pra, nuk kanë më fortësinë, elasticitetin dhe trashësinë e duhur, ndërkohë që fillojnë të bien sidomos në pjesën e sipërme të kokës me shumicë.

nevojë të përdorni asnjë lloj mjekimi për rënien e flokëve, pasi shkaku i rënies nuk është i jashtëm, por i brendshëm e duke larguar shkaktarin e rënies mund të riktheni flokun në gjendjen e dëshiruar.

TRAJTIMI

Pasi të gjendet shkaku i rënies së flokëve mund të kurohet rënia e tyre. Kura kryesore përdoret në të gjitha rastet e rënies së flokëve. Kur individët kanë çrregullime hormonale bëhen shtesa të tjera dhe për këtë duhen parë të gjitha analizat e tyre dhe përdoret një kurë komplekse. Për të ndihmuar në forcimin e rrënjës së flokut përdoret çaji kundër rënies së flokut, i cili përmban gjethe e rrënjë hithre, rozmarinë, bisht

kali etj. Ky çaj ushqen rrënjën e flokut e ndihmon në daljen e flokëve të reja. Pasi lahen flokët me shampo normalisht, shpëlahen me çajin, dhe jo me ujë të pastër. Çaji qëndron në gjithë flokun duke ndikuar gjatë gjithë kohës në formimin e tij. Floku lahet maksimumi 2 herë në javë pasi larja e shpeshtë e tij ndikon në rënie (largon bakteret e yndyrën e “mirë” që ndodhet në flokë duke e dobësuar në tërësi dhe rrënjën e tij). Nëse e keni të pamundur të gjeni kohë për përgatitjen e çajit mund të përdorni ekstraktin e këtij çaji, i cili ka të njëjtët përbërës duke i spërkatur flokët 3-4 herë në javë. Ky ekstrakt nuk ka aromë apo ngjyrë, thahet menjëherë, gjithashtu, ndihmon në kontrollin e yndyrës në flokët. Gjithashtu, në 600ml shampo shtohet 1 lugë gjelle vaj bajamesh të egra. Shampot përmbajnë paraben, bojëra, aromatizues, të gjitha këto qëndrojnë në rrënjën e flokut dhe e dëmtojnë atë. Vaji i bajames ndikon në zvogëlimin e efektit të këtyre përbërësve, dhe ndihmon në shpëlarjen e tyre sa më shpejt nga floku. Gjithashtu, përmban shumë vitaminë E që ushqen dhe zbut flokun. Çaji shoqërohet me një maskë për flokët që përmban ekstrakt hudhre dhe qepe, ekstrakt bisht kali, vaj livando, kokosi, rozmarinë. Të gjitha këto bëjnë që të largohen të gjitha infeksionet në lëkurën e kokës, si dhe ushqejnë dhe forcojnë rrënjën e flokut. Nëse keni probleme me irritimin e lëkurës së kokës nga psoriasis apo ekzema këshillohet të përdoret maska në vazhdimësi pasi nuk lejon të shfaqet asnjë plagë apo irritim në lëkurë, si dhe normalizon pH e lëkurës.



Presidenti i Republikës, Ilir Meta në malin e Tomorit

Festa e Shenjtë e Bektashinjve, presidenti me familjen përkahe Kryegjyshit Edmond Brahimaj

Ilir Meta në pelegrinazhin në Tomor: Zoti e desh, Shqipëria s'mbet e gjorë

“Abaz Aliu, misionari që u dogj për të ndriçuar njerëzimin”

Presidenti i Republikës, Ilir Meta mori pjesë dje paradite në pelegrinazhin në malin e Tomorit, ku përshëndeti Festën e shenjtë Bektashiane të Abaz Aliut.

Në prani të Kryegjyshit Botëror të Bektashinjve, Haxhi Baba Edmond Brahimaj dhe mijëra besimtarëve bektashianë, Presidenti Meta vlerësoi pelegrinazhin e përvitshëm madhështor në malin e Tomorit, ndërsa foli edhe për figurën e jashtëzakonshme të Abaz Aliut, që edhe sot e kësaj dite vazhdon të frymëzojë brezat e rinj dhe besimtarët bektashinj.

Në fjalën e tij, kreu i shtetit theksoi: “Abaz Aliu zu’ Tomorri, Erdhi afër nesh, Shqipëria s’mbet e gjorë, Se Zoti e desh”.

Me këto vargje gdhendi dashurinë e të gjithë shqiptarëve dhe adhurimin, që vazhdon edhe sot e kësaj dite, poeti i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, Naim Frashëri për martirin e Qerbelasë, Abaz Aliun.

Këto vargje, të cilat janë të gdhendura edhe atje lart në majën më të lartë të malit të Tomorit në radhë të parë janë të gdhendura në shpirtin e çdo besimtari bektashian. Ishe koha kur kërkohet një fuqi e mbinatyrshme për të përballuar të keqen, dëshpërimin, për të përballuar përçarjen dhe për të vendosur themel e një Rilindjeje Kombëtare që do të sillte shpëtimin e Shqipërisë dhe



Presidenti i Republikës, Ilir Meta dje gjatë pelegrinazhin në malin e Tomorit, ku përshëndeti Festën e shenjtë Bektashiane të Abaz Aliut

të kombit shqiptar.

Ndaj dhe jo rastësisht poeti ynë i madh Naim Frashëri shkroi me kaq adhurim, pasion dhe frymëzim për figurën e mbinatyrshme të Abaz Aliut.

Dhe sot e kësaj dite ne shohim me kënaqësi se madhështia e veprës të jashtëzakonshme në dobi të njerëzimit dhe të vlerave më të larta dhe të përjetshme

njerëzore të Abaz Aliut i tërheq si një magnet besimtarësh shqiptarë dhe nga e gjithë bota në këtë mal të shenjtë.

Bektashizmi që si devizë të tij ka pasur gjithmonë “Pa atdhe nuk ka fe” është në radhë të parë një përkushtim ndaj atdheut, ndaj kombit, është një shërbim për bashkëjetesën, për tolerancën, për bashkëpun-

imin në shërbim të një çështjeje më të madhe e që na bashkon të gjithëve. Ndaj ne jemi sot këtu për t’u përkulur me respektin më të thellë për të gjithë veprën që ka realizuar e vazhdon edhe sot e kësaj dite, Kryegjyshata Botërore e Bektashinjve në Shqipëri, pavarësisht nga sfidat e shumta.

“Bota nuk u takon atyre

MESAZHI I PRESIDENTIT

“Kemi nevojë ta duam njëri-tjetrin më shumë dhe t’i japim edhe më shumë shpresë, besim dhe durim të rinjve dhe të rejave tanë në mënyrë që ata ta shikojnë të ardhmen në këto vise të mrekullueshme ku mundësitë për zhvillim janë shumë më të mëdha”, -tha Meta.

marrje mjaft të gjerë në këtë pelegrinazh dhe ky është tregues dhe i adhurimit për këtë figurë të jashtëzakonshme, frymëzuese edhe në ditët tona, që u jep të gjithëve forcë për të përballuar vështirësitë e sfidat.

Njëkohësisht është edhe një mundësi që duke ardhur këtu të kujtojmë edhe njerëzit tanë të dashur, të kujtojmë edhe ata të cilët janë në gjendje të vështirë, që kanë nevojë për ndihmën tonë, që të ndajnë mbështetjen dhe solidaritetin e shoqërisë sonë.

Sepse kjo shoqëri mund të ketë të ardhme vetëm bazuar në këto vlera shumë të fuqishme njerëzore e shoqërore për të cilat u sakrifikuua Abaz Aliu dhe mjaft figura të tjera.

Kemi nevojë ta duam njëri-tjetrin më shumë dhe t’i japim edhe më shumë shpresë, besim dhe durim të rinjve dhe të rejave tanë në mënyrë që ata ta shikojnë të ardhmen në këto vise të mrekullueshme ku mundësitë për zhvillim janë shumë më të mëdha. Dhe për këtë na duhet t’u kthehemi gjithmonë atyre vlerave që e mbajnë një komb, që e mbajnë një shoqëri të fortë, të shëndetshme dhe shpresëdhënëse sidomos për gjenarat më të reja.

Duke falënderuar Kryegjyshin Botëror, Haxhi Dede Edmond Brahimaj, për ftesën dhe për këtë organizim të veçantë ju uroj të gjithë besimtarëve fat, mbarësi! Na ndihmofte të gjithë shqiptarëve Abaz Aliu për një të ardhme më të mirë dhe për të qenë gjithmonë të bashkuar në paqe dhe begati!”



Ish-diplomati amerikan: Nëse Kosova s'është pjesë e OKB, s'ka shumë mundësi për rezultat

James Hooper: Marrëveshja me Serbinë, marrëdhënie e re me SHBA-të

"Kosovarët të mendohen me 'kokë të ftohtë'"

James Hooper, ish-diplomati amerikan dhe një hësi i zhvillimeve në Ballkan, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë ka thënë se populli i Kosovës duhet ta kuptojë se Shtetet e Bashkuara të ditës së sotme s'janë Shtetet e Bashkuara të viteve 1998, 1999, 2000 dhe se situata ka ndryshuar. Hooper duke folur për idenë e presidentit Hashim Thaçi rreth kufijve, tha se populli i Kosovës duhet që këtë çështje ta shohë në perspektivë dhe t'i qaset këtyre diskutimeve me kokë të ftohtë. "Dua të porosis fillimisht që populli i Kosovës ta shohë këtë çështje në perspektivë dhe në veçanti t'i qaset këtyre diskutimeve me kokë të ftohtë", me gjakftohtësi dhe pa emocione. Mendoj që është shumë e rëndësishme që të shohim rezultatin e këtyre deklaratave. Ja pse! E gjithë kjo është projektuar si debat për kufijtë, qoftë për faktin e kufijve, korrigjimin apo diçka tjetër. Mirëpo e gjithë kjo në fakt përbën diskutim për një marrëveshje që do të ndryshojë marrëdhënien e Kosovës me Shtetet e Bashkuara dhe Europën dhe ndryshim në aspektin pozitiv, pra do të përmirësojë lidhjet. Kjo nuk ka të bëjë vetëm me marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë. Prandaj unë vërtetë dua të përçoj këtë mesazh që populli i Kosovës duhet ta mendojë mirë këtë proces, me shumë kujdes, sepse po bisedohet për marrëdhënien e ardhshme që do të ketë me SHBA-të dhe Evropën", theksoi Hooper. Ai tha se ekziston një rrezik i konsiderueshëm, që ndryshimi i kufijve mes Kosovës dhe Serbisë, mund të ndikojë në Maqedoninë dhe Bosnjë, prandaj sipas tij, është kaq e rëndësishme që kjo çështje të shihet në një perspektivë më të gjerë dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë i përfshirë. "Është shumë e rëndësishme që komuniteti ndërkombëtar të tregojë përkushtim për rezultatin,



James Hooper, ish-diplomati amerikan

për marrëveshjen që do të arrihet. Ndoshta edhe nuk do të ketë të tillë, apo ajo se për çfarë do të pajtohen palët nuk do të jetë aq e madhe sa, në fakt, njerëzit janë të shqetësuar. Mirëpo është shumë e rëndësishme për stabilitetin rajonal, që komuniteti ndërkombëtar ta shohë këtë çështje në perspektivë më të gjerë. Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara duhet t'i shohin këto diskutime si pjesë të ristabilizimit të Ballkanit, sepse situata në Bosnjë nuk është stabile në shumë aspekte dhe gjithmonë ka brenge për Maqedoninë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të jetë pjesë e stabilizimit të rajonit dhe kjo është pjesërisht se nga janë duke shkruar bisedimet në mënyrë indirekte. Dhe sërish, kjo duhet të jetë edhe pjesë e përgjegjësisë së udhëheqësisë së Kosovës, me mbajtjen e këtyre negociatave dhe bisedimeve", tha ai.

Hooper theksoi se Uashingtoni ka një perspektivë ndryshe rreth kësaj çështjeje, për dallim nga Berlioni dhe Londra. "Mendoj se Uashingtoni me siguri ka një perspektivë ndryshe në këtë çështje, për dallim nga Berlioni dhe Londra. Populli i Kosovës duhet të studiojë këtë dhe të kuptojë se Shtetet e Bashkuara të ditës së sotme nuk janë Shtetet e Bashkuara të viteve 1998, 1999, 2000 e kështu me radhë. Situata ka ndryshuar. Siç e shoh unë, kjo e vë në pah vëntirësinë e Kosovës në të qenit shtet i vogël në një rajon jo të qëndrueshëm. Është shumë e rrezikshme në këto ditë për Kosovën që të nisat drejt së ardhmes derisa është fqinje me një Serbi armiqësore. Zbutja e armiqësisë së Serbisë është e rëndësishme për Kosovën. Mbajeni në mend se sa i përket rajonit, rruga nëpër të cilën është nisur Kosova është e mbushur me plot gropa. Kos-

ovës i duhet gjithmonë një 'ngasës' i mirë. Në këtë aspekt varet nëse populli i Kosovës i beson udhëheqësisë së vet. Ndohet e di se ka pasur kritika për politikën e brendshme, në rastin e presidentit Thaçi, mendoj se ai i ka ofruar Kosovës udhëheqësi të mirë në çështje ndërkombëtare, ndaj populli i Kosovës duhet ta ketë parasysh këtë gjë". "Një nga arsyet se pse mendoj që janë shqetësuar njerëzit është fakti se gradualisht rajoni ka rrrëshqitur në një formë të jostabilitetit. Prandaj mendoj se ka shqetësim tek ata. Një tjetër arsye, nga ajo çfarë kam dëgjuar është se meqë zonja Mogherini [Federica] përfundon mandatin vitin e ardhshëm, ka pasur zëra se ajo do të dëshirojë arrijtjen e një marrëveshjeje, të cilën mund ta konsiderojë si trofe të saj. Prishtina duhet të ketë kujdes në këtë aspekt, sepse këtu mund të ketë diçka të vërtetë që zonja Mogherini të dëshirojë të mbahet në mend si ministre e Jashtëme e suksesshme. Por çfarë në të vërtetë përbën rrezik për mua është nëse arrihet marrëveshjeje me një njeri që tashmë është duke u larguar, sepse në rast të arrijtes së marrëveshjes, palëve ju duhet një person, në këtë rast zonja Mogherini që të jetë aty për t'i siguruar se marrëdhëniet e reja [pakti] të zbatohet ashtu siç është hartuar. Nëse kjo arrihet para largimit të saj, cili do të jetë ndikimi i saj në të ardh-

men?", tha ai. Sipas tij, presidenti Thaçi duhet të sigurohet që nëse do të ketë ndonjë nënshkrim të marrëveshjes në të cilën përfshihet edhe Mogherini, atëherë duhet të nënkuptohet që marrëveshja të përkrahët edhe nga Kancelarja gjermane Merkel apo persona tjerë që do të jenë aty më gjatë se Mogherini. Njohësi i çështjeve në Ballkan tha se secila palë synon të përmushë ambiciet maksimale, pa dhënë asgjë dhe kjo sipas tij është recetë për jostabilitet dhe rikthim të dhunës në të ardhmen në rajon. "Marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë janë më të rëndësishme në rajon. Nuk e di cili do të jetë rezultati në fund dhe nuk mendoj se madje as vetë zoti Thaçi apo zoti Vuçiq janë në dijeni të rezultati, ata mund të jenë duke testuar se sa janë të përkushtuara SHBA-ja dhe Evropa. Mirëpo mendoj se është e rëndësishme që kjo të mos shihet në aspektin provincial, nëse më lejohet të them. Çfarë do të vendosja unë në plan të parë, para Bosnjës dhe Maqedonisë, është ajo nëse Kosova, si rezultat i marrëveshjes, do të pranohet në Kombet e Bashkuara. Në një rast të tillë, mendoj se ka argumente bindëse për një marrëveshje. Nëse Kosova nuk do të jetë pjesë e OKB-së, atëherë mendoj se ka pak mundësi që ndonjë marrëveshje të arrihet", tha ai.

SHKURT

Venezuelë, tërmet i fuqishëm me magnitudë 7.3 ballë

Një tërmet i fuqishëm tronditi Venezuelën Veriore të martën në mbrëmje. Raportet para-prake nga shërbimi sizmologjik tregojnë se tërmeti ka qenë më magnitudë 7,3 ballë. Lëkundjet e tërmetit u regjistruan në qytetin bregdetar të Irapés, ku shumë ndërtesa u shkatërruan. Epiqendra e tij ishte 20 kilometra në Veri-Perëndim të Yaguaraparos. Deri më tani nuk ka raportime për persona të vdekur, por vetëm dëme materiale.

E frikshme në Rusi, shpërthen në ajër motori i avionit

Një avion i linjës ajrore Red Wings në Rusi, i cili u nis nga qyteti Ufa për në Soçi mëngjesin e së mërkurës, u kthye në aeroport vetëm disa minuta pas ngritjes për shkak të shpërthimit të motorit të majtë. Fatmirësisht incidenti nuk ka shkakuar viktima. Të gjithë shërbimet e zjarrfikëses u vunë në lëvizje, raporton Sputnik. "Pasagjerët u evakuuan me ndihmën e rrëshqitëseve shtatë minuta pas uljes së avionit. Në orën 5.22 të mëngjesit në morëm sinjale për ngjarjen", tha një përfaqësues i aeroportit në një deklaratë. Avioni është pezulluar dhe një hetim po zhvillohet për të zbuluar shkakun e ngjarjes. Linja ajrore po merr masa për të dërguar pasagjerët në Soçi. Ndërkohë aeroporti i qyteti Ufa vazhdon fluturimet si zakonisht.

Meksikë, miratohet ligji për marrëdhëniet seksuale në publik

Është miratuar ndryshimi ligjor që tanimë lejon marrëdhëniet seksuale në publik, duke siguruar që askush nuk do të ankohe për të, në një qytet të Meksikës. Sipas një këshilltari, që ishte edhe iniciatori, ky veprim ka si qëllim të ndalojë policinë e Guadalaajarës, një qytet me 1.5 milionë banorë, të arrestojë çiftet që i japin njëri-tjetrit dashuri në publik. Këshilli i qytetit e shtyu reformën javën e kaluar, por tanimë thotë: Politikani Guadalupe Morfin Otero, që propozoi dhe ndryshimin e ligjit, përmendi një studim për studentët e universiteteve, 90 për qind e të cilëve thanë se ishin grabitur nga efektivet e policisë, të cilët i akuzonin për veprime morale. Ligjërisht shpeshojnë që ky ndryshim do të lejojë policinë të fokusohet më tepër në luftën kundër krimeve më të rënda.

Daçiç: Prokurori u largua se po hetonte krimet e UÇK-së

Protestë kundër kryeprokurorit në Kosovë: Të shkarkohet, i lidhur me politikën

Pas debatit që shkaktoi dorëheqja e prokurorit Elez Blakaj dhe publikimit të aktakuzës tashmë të njohur si "Veterani i rrëzshëm", janë nxjerr në pah lidhjet mes politikës dhe Prokurorisë së Shtetit. Regjimet e politikanëve dhe të Prokurorisë pas denoncimit nga ish-prokurori Blakaj të ndërhyrjeve të kryeprokurorit Aleksandër Lumezi dhe të segmenteve të politikës në punën e tij e konfirmojnë thellimin e krizës në vetë sistemin e korruptuar politik dhe atë të drejtësisë. Përdërisa politikanët po e shajnë e akuzojnë ish-prokurorin dhe vetë sistemin prokurorial po distancohet prej tij, shoqëria civile po organizohet të protestojë. Dje, për herë të parë pas luftës, qytetarët të orga-



Ivica Dačić

nizuar nga pjesëtarë të shoqërisë civile protestuan para institucionit të kryeprokurorit të shtetit me kërkesën për shkarkim të Lumezit për shkak të lidhjeve të tij me politikën. Prokuroria e Shtetit të hënën, me qëllim të sqarimit të faktit nëse ka ose jo ak-

takuzë për këtë rast, ka thirrur një konferencë për media. Pa kaluar as tri orë, përmes një letre, ish-prokurori Blakaj, ka rrëfyer versionin e tij. Ka thënë se është kërcënuar për rastin e aktakuzës, por nuk është tërhequr për atë shkak. Ka përmendur presionet që, si-

pas tij, ia ka bërë kryeprokurori i shtetit, Aleksandër Lumezi, raporton koha. Ndërkaq, nga Rusia, ministri i Jashtëm serb, Ivica Daçiç ka keqinterpretuar dorëheqjen e prokurorit, Elez Blakaj, duke thënë se ai u dorëhoq për shkak të presioneve nga veteranët, meqë po hetonte krimet e UÇK-së. "Pala shqiptare nuk zbaton asgjë nga ajo çfarë jemi marrëveshje. Ne duam që të arrijmë deri të një kompromis, por është e qartë se ekziston një standard i dyfishtë se si Perëndimi e trajton Prishtinën", ka thënë Daçiç në Soçi. "Tani një prokuror për

IVICA DAÇIÇ: "Pala shqiptare nuk zbaton asgjë nga ajo çfarë jemi marrëveshje. Ne duam që të arrijmë deri të një kompromis, por është e qartë se ekziston një standard i dyfishtë se si Perëndimi e trajton Prishtinën", ka thënë Daçiç në Soçi.

krime lufte, shqiptar, ka dhënë dorëheqje për shkak të presionit nga veteranët, sepse po hetonte krimet e luftës së UÇK-së. Ne do të vazhdojmë të jemi në bashkëpunim të ngushtë me Rusinë dhe Presidentin Putin, sepse pa Rusinë nuk ka zgjidhje të qëndrueshme", është shprehur ai.

MREKULLITË SHËNDETËSORE QË SJELL KONSUMIMI I PJEPRIT

SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETA SHQIPTARE

E enjte 23 Gusht 2018



RASHELI NUK PËRMBAHET MË, POSTON VIDEON HOT



Marina Vjolca tregon barkun dhe na la pa fjalë

BULEVARDI POLITIK



- Meta e Kryemadhi pelegrinazh në malin e Tomorit, luten për shqiptarët
- Luan Rama i LSI kërcen në Jalë për Luana Vjollcën
- Nudo në shatërvanin e Romës, ministri Salvini: Di unë si t'i edukoj këta idiotë!
- Deputeti Tahiri dhuron rrogën e tij, për familjet në nevojë



Rrëfehet aktori: Ja nga se hoqa dorë për hatër të fëmijëve

GENTIAN ZENELAJ:

Të gjithë politikanëve antishqiptarë do u hiqja patentën

"Salmir Kodrës nuk duhet t'i thuash "Stop" për asgjë"

Rrëfihet aktori: Ja nga se hoqa dorë për hatër të fëmijëve

Gentian Zenelaj:

Të gjithë politikanëve antishqiptarë do u hiqja patentën

"Saimir Kodrës nuk duhet t'i thuash "Stop" për asgjë"

Egla Xhemali

Fundi i kësaj vere për aktorin Gentian Zenelaj do të thotë një ngjyrë më e mirë nga plazhi dhe një aksion, që nis me sezonin e ri në TV dhe teatër. Në takimin që patëm me të gjithë shoqi sikur njiheshim prej vitesh. I mësuar me intervista, na tregoi për suplementin "Summer pages" të "Gazeta Shqiptare" për veten, familjen, punën dhe kolegun e tij Saimir Kodrën. Ishim bërë gati për një "shfaqje" humorit, por jo, shanset qenë zero. Genti është kaq serioz, sa duhet të sigurohesh nëse po bisedon me të njëjtin person, që kishe në telefon. Ai i rikthehet "Stopit" në TV "Klan" bashkë me Saimir Kodrën, që për të është një makineri që nuk ndalet, vetëm punon. Sa për fëmijët dhe gruan ka "hapur" goxha thesin duke na treguar të fshehtat e udhëtimeve. Një baba me "medalje ari" si ai, ka bërë një përpjekje, që i rezultoi me sukses, la cigaren. Si mjeshër i improvizimit të batutave, në rreshta lexon për situatat, jo pak të vështira ku ka futur kolegët. Po qëndrimi i tij për teatrin? Një sfidë e hapur, me tone të larta për ta mbrojtur deri në fund.

Si është për ty dita e parë e kthimit në punë pas pushimeve?

Nuk e përcaktoj dot këtë gjë pasi puna nuk ndalon, pra gjatë gjithë verës përveç këtyre shkëputjeve të shkurtra, unë kam qenë në punë. Jam marrë me projekte që do të vijnë. Emisioni "Stop" vazhdon punën, mesazhet e njerëzve vijnë. Ne nuk e fikim celularin. Gazetarët duhet të orientohen në terren, problematikën e njerëzve vijnë dhe të gjitha duhen lexuar. Pra, nuk është kjo. Mbaroj data 31 gusht dhe tani fillon një episode i ri. Puna nuk ndryshon asnjëherë të paktën për njerëzit e medias.

Për çfarë mund t'i thuash "Stop" Saimir Kodrës?

Saimir Kodra është njeriu që nuk duhet t'i thuash "Stop" për asgjë, sepse Saimiri nuk ndalet. Ai është një makineri që punon non-stop, sidomos sa i përket emisionit. Është një makineri që vazhdimisht prodhon tema, direktiva. Saimiri ka një eksperiencë mjaft të madhe dhe nuk është pak të drejtosh një institucion si është "Stop-i". E theksoj faktin institucion pasi po i jep zgjidhje problematikave të njerëzve që kanë dhjetëra vite që vijnë vërdallë dhe nuk është pak. Nuk dua t'i them "Stop" për asgjë. Saimir mos ndalo! (qesh)

Si sillësh me policët kur rrezikon ndonjë gjobë?

Të them të drejtën unë jam shofer shumë i kujdesshëm. Ka momente që e shkel me shpejtësinë. E urrej që kur bëj një rrugë të gjatë detyrohem që për shkak të saj të futem në qytete si për shembull në Fier, Vlorë. Kur dua të shkoj në destinacione të gjata kam dëshirë që të eci. Jam njeri që kur jam në timonë mund të udhëtoj me orë të tëra dhe nuk lodhem. Përgjithësisht, nuk abuzoj në mënyrë skandaloze, po ma beso sa herë që më kanë ndaluar unë kam nxjerrë dokumentat. Le të marrë atë që meriton nuk bëj asnjëherë prepotentin, arrogantin. Më nervozojnë shumë policët prepotentë dhe të pasjellshëm. Ka pasur dhe raste që kam shkruar në debat, sepse kur unë them "Mirëdita" e kam shumë problem kur ti s'më përshëndet ose kur nuk



thua "Zoti qytetar". Sigurisht ato janë të stresuar, sepse realisht në Shqipëri të menaxhosh shoferët shqiptarë është një stres i paparë. Unë i kuptoj të gjithë djemtë e qarkullimit dhe policinë, pasi Shqipëria është sa i përket qarkullimit dhe mirësjelljes në përgjithësi është një kaos total, është tmerr. Duhet të kesh nerva, që të dish çfarë njerëzish janë. Gjej rastin ti përshëndes të gjithë dhe atyre policëve që mund ti kem thënë ndonjë fjalë u kërkoj falje.

Një aktor humorit, deri ku shkon me batutat në familje?

Unë përpiqem të krijoi situ-

ata, në fakt. Jam natyrë që kam shumë qejf të marr familjen me vete të udhëtojme. Më ka rastisur një bashkëshorte gjumashe në udhëtim dhe djali, po aшту. Po shqyrr Aria po e kompenzon, që është një llafazane e paparë. Përgjithësisht, udhëtimet tona janë të zhurmshme, alegro në makinë. Në situatat kur dalim jam pozitiv, energjik. Duhet të kuptosh që puna që bëj sigurisht që influencën. Vjen një mesazh dhe ti lexon një informacion shumë të trishtë për dikë dhe do isha idiot po të thosha që nuk influencën në jetën time të përditshme gjithë ky informacion dhe problematikën që marrë nga njerëzit megjithëse unë mundohem ta ndaj, por është e pamundur. Ka njerëz që më shkruajnë në 12 të natës kam hall e patjetër që duhet t'u përgjigjesh të gjithëve.

Si baba, nga çfarë ke hequr dorë?

Për hatër të fëmijëve unë kam lënë cigaren dhe jam njeriu më i lumtur në botë dhe u bëj thirrje të gjithë atyre që pinë cigare, pasi është gjëja më e lehtë. Mos i dëgjoni fjalët që është gjëja më e vështirë, nuk bëhet.

Lini cigaren, pasi është armiku më i madh! Mbas dy fëmijëve të mi është arritja më e madhe në jetë, pasi e kam pirë për 25 vjet.

Një rol që do e luaje pafund dhe pse?

Ka role shumë të mira, ka role të dobët, ka role çka. Ne aktorët për të gjitha rolet investojmë njësoj. Impakti që ka me publikun është i ndryshëm. Ekziston një shprehje, që e ka thënë një aktore shqiptare "Ti je ajo që ke luajtur herën e fundit", pra në aspektin profesional nëse e ke luajtur dobët je dobët, në qoftë se e ke luajtur shumë mirë je mirë. Unë mundohem të jem energjik, i shinqertë me publikun dhe kam filluar të kuptoj që publiku po largohet pak na aktorët që luajnë pak me vetësiguri se e kanë në dorë publikun. Ata po afrohen ndaj aktorëve të cilët shpenzojnë energji, publiku e ndjen që ai është lodhur. Shfaqet e mia unë i zgjedh me role shumë aktive, nga fillimi deri në fund ka shumë aktivitet. Mund të gënjëjnë përmasat e mia po jam natyrë shumë energjike. Nuk veçoj asnjë rol. Për mua janë të gjithë dashuri me shikim të parë.

Kur të kap e qeshura në skenë apo studio, çfarë bën për t'u kthyer në seriozitet? Ka situatë që ti i provokon të qeshurat, ka situata ku realisht qesh me sinqeritet. Më ka rastisur 2-3 herë në shfaqje kam qenë me Romirin. Një e qeshur që shkaktohet çuditërisht dhe publiku qeshte njësoj me ne. Është gati si një valvul shfryrje. Është një moment kur për pak sekonda pritë që ne të jemi në skenë ata janë në publik, pra duket sikur të gjithë jemi bashkë dhe janë momente shumë të bukura. Unë kam dy momente me Romirin gjatë shfaqjeve që janë spektakolare, që ka ndodhur krejt rastësisht. Unë i kam shumë qejf këto momente kur janë të sinqerta, pastaj kur janë të provokuara janë një shpifësirë e gjallë. Njerëz jemi dhe ne. Një batutë që bën për të qeshur bën për të qeshur, si atë që thotë batutën dhe publikun. Emisioni "Stop" është ai që shihet në ekran. Nuk është asgjë me skenar dhe imagjino improvizimet tona se si mund të dëgjoen. Realisht, Saimiri kur qesh, qesh me shpirt. I dalin lot nga sytë se batuta që më ka thënë mua ose i kam thënë unë ka qenë krejt spontane. Nuk është batutë, që unë e kam përgatitur me dhjetëra herë dhe sigurisht që provokon të qeshura. Qeshin kameramanët, qesh teknika, qeshin të gjithë.

Cilit politikan do të doje t'i hiqje patentën?

Të gjithë politikanëve antishqiptarë do u hiqja patentën. Unë s'e imagjinoj dot që një politikan shqiptar zgjohet në mëngjes dhe mos të mendoj se si ta bëj jetën e popullit. Për mua gjithë shqiptarët duhet t'ia heqin vizën. Një politikan që interesat i çon te një njeri, për një rrugë, një aeroport, koncesion dhe nuk mendon për shumicën për mua i duhet hequr vizën në momentin më të parë, si të majtë, si të djathtë qofshin. Kjo për mua nuk ka rëndësi. Mua kanë filluar të më shqetësojnë shumë politikanët



RASHELI NUK PËRMBAHET MË, POSTON VIDEON HOT



Edhe pse në një moshë të re, Rashel Kolaneci konsiderohet tashmë si një prej femrave më seksi të showbiz-it shqiptar. Bukuroshja ka qenë mjaft aktive kohëve të fundit në rrjetin social "Instagram", ku ndan me të gjithë fansat foto nga këto ditë të nxehta vere e padyshim ngjall komente nga më të ndryshmet. Nuk kishte si të ndodhte ndryshe dhe këtë herë. Së fundmi, ajo ka postuar një video mjaft sensuale para pasqyrës me një rrobebanjo jeshil, që e tregon atë më në formë se kurrë. Nuk kanë qenë të pakta reagimet pozitive për videon nga fansat e saj.

MARINA VJOLLA TREGON BARKUN DHE NA LA PA




Marina Vjolla dhe reperi Getoar Selimi verën e kaluar i dhanë fund beqarisë në një dasmë madhështore që mori vëmendjen e të gjitha mediave. Prej kohësh moderatorja është përfolur shumë në media kjo pasi përveç daljeve televizive aludohet se ajo është në pritje të një fëmije. Para dy ditësh motra e saj, moderatorja e famshme Luana Vjolla ka publikuar një video ku shihej me Marinën dhe me mbesën e tyre. E ndikuar dhe nga fjalët që po qarkullojnë ditë e fundit bukurshja ka hequr çdo dyshim për shtatzëni të mundshme. Ajo ka postuar në rrjetin social "Instagram" një foto ku duket tejet në formë dhe se barku i saj nuk është i rrumbullakët siç pretendohet nga

MORENA TARAKU MË SEKSI SE KURRË



Morena Taraku njihet si njëra ndër femrat më seksi në tregun muzikor. Emri i këngëtares shqiptare u komentua gjatë për shkak të lidhjes së shkurtër që pati me milionerin iranian. Bukuroshja ka qenë me postimet më aktive se kurrë në këto ditë të nxehta vere. Në foton e fundit që Taraku ka ndarë në "Instagram" duket më në joshëse se kurrë. Me bikinit fosforeshente ajo ka treguar linjat trupore perfektë. "Shumë nxehtë", ka shkruar Morena pranë imazhit ndërsa ndjekësit janë vërsuar me komente të ndryshme.



antishqiptarë, antikombëtarë. Hilari Klinton ka mbajtur një fjalim spektakolar në parlamentin shqiptar dhe unë vura re që disa politikanë shqiptar qeshnin. Ajo ka thënë një fjali tekstualisht kështu "unë isha kundër Barak Obamës në zgjedhjet presidenciale, por në një moment ai më tha eja të bashkëpunojmë dhe unë pranova të bashkëpunoj, sepse për mua Amerika është mbi gjithçka". Këto njerëz kanë marrë votat tona dhe nuk i meritojnë votat e shqiptarëve e them për të gjithë kasën politike në Shqipëri. Ditën që do vihet vendi mbi gjithçka, atëherë Shqipëria do bëhet më e mirë. Kur të vij ai mëngjes dhe të mendohet si do bëhet jeta e popullit shqiptar më e mirë në kuptimin real të fjalës, jo për propaganda, po që shqiptarët duhet ti largohen politikës me pamjet e xhiruara me dron, unë do e votoj atë politikanë që zgjedhet më mirë dhe më i mirë për Shqipërinë. Të



tjerët që mendojnë se si të vënë një taksë abuzive, se si mendojnë të bëjnë diçka, e cila do të rëndojë në kurriz të konsumatorëve shqiptarë për mua duhet t'i

hiqet viza, patenta, vota gjithçka. Janë njerëzit më të ligj që ekzistojnë. **Projekte të reja?** Të them të drejtën kam kaluar një vit shumë të

ngarkuar ku nxora tri projekte dhe ka qenë një vit tepër i lodhshëm. Ndiem paksa fajtor ndaj familjes, sepse kam kaluar fundjava të tëra me turne, shfaqje

ndërkohë që ata presin të jem me ta. Kam bërë një farë premtimi që do i shoh me shumë kujdes projektet e reja, pra ka shumë mundësi që unë të menaxhoj këto projekte që kam që do rikthehen përsëri dhe do shoh me shumë kujdes të paktën nga janari nuk kam ndërmend të lançoj projekte. Kërkesa kam plot, po është tepër e lodhshme të bësh edhe "Stop-in" edhe teatritin pasi jemi dhe me problematikën e tij. Realisht kjo na konsumon energji. **Meqë mbërritëm në këtë pikë. Ti je për prishjen e teatrit apo jo?** Në asnjë mënyrë. Nuk mund ta nxjerr nga goja fjalën të prishet teatri. Çfarë artisti është ai? Fjalja: le ta prishim këtë teatër, nuk duhet të jetë kështu, por të jetë: le ta ndërtojmë këtë teatër. Nuk mund ta instancoj dot, që në këtë institucion që është ndërtesa ku është themeluar çdo insti-

tucion artistik shqiptar në historinë e artit. T'i dali nga goja disa aktorëve fjalja 'le ta prishim' është e tmerrshme. Sa kollaj është që ta prishësh! Merr një fadromë dhe prishet brenda ditës. Të ruash është vështirë. Është memorie qytetare. Ato kolegët tanë që kanë vënë firmën duke thënë që të prishet uroj t'i zëri gjumi natën. Është fjalë e rëndë shumë të prishet. Aty janë bërë gjyqet e para të komunizmit për njerëz, që janë pushkatuar, është teatri më i vjetër në Shqipëri, si të del nga goja fjala të prishet?! Mund t'i dali një inxhinieri, një politikan, po një artisti nuk mund t'i dali kurrë të prishet. Artisti nuk është për të prishur, por për të ndërtuar. Nejsë ata e dinë vet. E kanë engjëllin dhe djalin vet brenda tyre, varet cilin prej këtyre të dyve kanë më të madhin. Unë i kam të dy njësoj. Dua një teatër shumë të mirë, me ngrohje, por nuk mund të kërkohet ngrohje duke prishur diçka. Jemi përditë aty në betejë.



Pjepri është një ndër frutat më të mira për t'u konsumuar në këto ditë të nxehta vere. I ëmbël, i freskët, por edhe tejet i shijshëm, pjepri duhet të jetë patjetër pjesë e listës së frutave që duhen blerë.


Falë përbërjes së lartë në vitamina dhe minerale, mund të konsiderohet "minierë ari". Për të përfituar më së miri nga vlerat e larta ushqyese të këtij fruti preferohet të konsumohet brenda muajve prill-gusht, që njihet edhe si sezoni i këtij fruti.

Ja 11 përfitimet shëndetësore që merren nga konsumimi i pjeprit:

Antikancer: Përmbajtja e lartë e karotenoideve në pjepër mund të parandalojë kancerin dhe të ulë rrezikun e kancerit të mushkërive. Konsumimi i rregullt i këtij fruti është efektiv në parandalimin dhe goditjen që në bërthamë të kancerit që pushton trupin tuaj. Prandaj përfshini pjeprin në dietën tuaj për të parandaluar këtë sëmundje vdekjeprurëse. **Mbron zembrën:** Një antikoagulant i quajtur adenozinë i pranishëm te pjeprit mund të ndalojë mpiksjen e qelizave të gjakut që shkakton goditje ose sëmundje të zembrës. Pjepri ul rrezikun e sëmundjeve të zembrës duke holluar gjakun në trup. Përveç kësaj, përmbajtja e lartë e ujit në pjepër ofron një efekt qetësues i cili ndihmon në lehtësimin e aciditetit në stomak. **Mbron veshkat:** Vetitë e shkëlqyera diuretike të pjeprit janë të dobishme në shërimin e sëmundjes së veshkave. Kështu, konsumi i rregullt i pjeprave çdo ditë në mëngjes ndihmon në ruajtjen e shëndetit të veshkave.

Ndihmon tretjen: Nëse kemi probleme me tretjen, mund të provoni të hani pjepër për të lehtësuar lëvizjen e ushqimeve nga aparati tretës, zorrë, drejt jashtëqitjes. Përmbajtja e lartë e ujit te pjepri është veti e shkëlqyer për sa i takon tretjes pasi ndihmon jashtëqitjen, ndërsa përmbajtja minerale eliminon aciditetin që shpesh shkakton vështirësi në tretje, veçanërisht në stomak.

MREKULLITË shëndetësore që sjell konsumimi i



Jep energji: Shumica e pjeprave përmbajnë vitaminë B të cilat përbëjnë pjesën më të madhe të prodhimit të energjisë në trupin tuaj. Vitaminat B kërkohen nga trupi juaj për të përpunuar sheqernat dhe karbohidratet. Ndaj dhe konsumimi i pjeprit mund t'ju japë energji të konsiderueshme.

Humbje peshe: Ashtu si shumica e frutave të tjera, pjeprat janë idealë për rënie nga pesha. Këta fruta janë në vlera të ulëta natriumi dhe kalorish, por kështu pa yndyrë dhe kolesterol.

Përmbajtja e lartë e ujit mund t'ju mbajë të plotë për më gjatë, ndërsa ëmbëlsia natyrale ul fërkimet tuaja për ushqime me sheqer dhe ëmbëlsira me kalori të larta.

Lëkurë e shëndetshme: Një nga vlerat kryesore të pjeprit është përmbajtja e lartë e kolagenit, i cili ruan integritetin e strukturës së qelizës në të gjitha indet lidhëse duke përfshirë lëkurën. Gjithashtu, përshpejton shërimin e plagëve dhe ruan qëndrueshmërinë e lëkurës. Konsumi i rregullt i pjeprit është i dobishëm për ata që kanë lëkurë

të thatë.

Kundër plakjes: Me konsumimin e pjeprit ne gjithashtu tonifikojmë lëkurën dhe sigurojmë përfitime kundër plakjes për shkak të pranisë së vitaminave A, B dhe C. Ju mund të përgatitni një maskë fytyre kundër plakjes duke prerë feta të hollë të pjeprit të freskët dhe t'i vendosini këto feta në fytyrën dhe qafen tuaj. Më pas shtrihuni dhe relaksohuni për 15 deri në 20 minuta. Shpëlar me ujë të freskët. Ky veprim do të freskojë lëkurën tuaj dhe do të sig-

urojë shkëlqim rinor.

Hidratues i mirë: Pjeprat kanë vetitë shumë të mira hidratuese dhe energjike. Ju mund të përgatitni një maskë fytyrash hidratuese duke prerë kastravec me pjepër dhe mjaltë.

Rrit flokët: Pjepri është burim i mirë i betakarrotinit që konvertohet në vitaminë A brenda trupit. Kjo vitaminë A është jetike për flokët e shëndetshëm dhe rritjen normale të flokëve. Ndaj me konsumimin e pjeprit, kemi rritje të shëndetshme të flokëve. Ashtu si pjesa tjetër e trupit, shëndeti i flokëve varet edhe nga ushqyesit që iu japim folikulave të flokëve për rritjen e tyre. Konsumi i frutave të pasura me vitaminë dhe minerale mund të nxisë rritjen e flokëve dhe parandalimin e problemeve të flokëve. Pjepri mund të jetë i dobishëm për flokët tuaj, sidomos për rritjen dhe mbajtjen e tyre sa më të shëndetshëm. Parandalon rënien e flokëve. Mangësitë në vitaminat B janë gjithashtu përgjegjës për shkaktimin e humbjes së flokëve. Pasi pjepri është i pasur me vitaminë B, si dhe acidi folik dhe inositol (substancë), të cilat ndihmojnë në parandalimin e rënies së flokëve dhe nxisin rritjen e tyre.

Vlerat ushqyese: Ky frutë është i mbushur me lëndë ushqyese të shëndetshme, që nga vitaminat, mineralet dhe antioksidantët.

Kalori: Ky frutë është shumë i varfër në kalori rreth 100 gramë frutë i freskët përmban vetëm 34 kalori.

Vitamina A: Pjepri është një frutë shembullor për sasinë e madhe të vitaminës A. 100 gramë pjepër i freskët përmban më shumë se 112% të sasisë ditore të rekomanduar me vitaminë A, (ky frutë mban rekord për sasinë e madhe të kësaj vitaminë).

Antioksidantë: Po kështu është i pasur me antioksidantë dhe flavonoidë, sikurse është betakarrotini, lutein, që luftojnë radikalët e lira dhe përbërës të tjerë, të cilat sigurojnë mbrojtje kundër disa llojeve të kancerit.

Meta e Kryemadhi pelegrinazh në malin e Tomorit, luten për shqiptarët

Ilir Meta dhe Monika Kryemadhi u janë bashkuar pelegrineve që po ngjisin malin e Tomorit. Presidenti së bashku me bashkëshorten dhe tre fëmijët, janë fotografuar në majë të malit. Ata janë lutur edhe për shqiptarët duke shpresuar që Abaz Alliu t'i ndihmojë. "Mirëmëngjesi nga maja e malit të shenjtë të Tomorit!" - shkruan Meta në rrjetin social 'Facebook'. Ndërkohë Monika Kryemadhi shkruan: "Ju uroj të gjithë bektashinjtë mbarësi e paqe! Abaz Alliu i ndihmofte të gjithë shqiptarët kudo!" - shkruan Kryemadhi.



Luan Rama i LSI kërcen në Jalë për Luana Vjollcën



Kampi i të rinjve të Lëvizjes Socialiste për Integrim ka nisur edhe për këtë vit në Jalë, aty ku edhe aktivistët e rinj mblidhen për të kaluar disa ditë ndryshe. Pas mbremjes së djeshme ku edhe pse shi, deputetët e LSI-së ia kanë marrë valles, festa ka vazhduar edhe dje. Në një video të shpërndarë në rrjetet sociale shohim deputetin Luan Rama duke kërcyer nën ritmet e këngës "Mi dhe flakë mallit tim", këngës më të fundit të Luana Vjollcës. Rama duket i rrethuar nga deputetë të tjerë dhe nga të rinjtë aktivistë.

BULEVARDI

POLITIK

Nga merrni seriozitet! 🍌

Nudo në shatërvanin e Romës, ministri Salvini: Di unë si t'i edukoj këta idiotë!



Një grup djemsh që u zhytën në shatërvan në Sheshin Venecia bëjnë bujë në mediat italiane. Shfaqjen, e parë shumë herë të tjera, por aspak të këndshme, e ka ofruar një nga djemtë, i cili ka hequr mbathjet duke dalë nudo. Skena është filmuar dhe është shpërndarë në rrjet nga Site 'Roma fa schifo'. Nuk është hera e parë që shatërvanët romanë bëhen pjesë e akteve vandaleske dhe e skenave të tilla. Pamjet e postuara në rrjet, nëpërmjet 'Twitter' dhe 'Facebook' kanë ngjallur indinjatë nga përdoruesit e internetit. Megjithatë zv/kryeministri dhe ministri i Brendshëm Matteo Salvini, i cili njihet tashmë për gjuhën e ashpër ndaj mafias, ka dhe një mesazh për këta persona. "Di unë si t'i edukoj këta idiotë nëse kapen, Italia nuk është dushi i shtëpive të tyre", - shkruan ai.

Deputeti Tahiri dhuron rrogën e tij, për familjet në nevojë

Deputeti kosovar ka vendosur që pagën e tij mujore ta japë për familjet në nevojë. Labinot Tahiri një ndër këngëtarët dhe artistët më me emër në muzikën shqiptare, tashmë i ka hyrë politikës dhe është deputet i Kosovës. Prej kohësh Tahiri njihet në Kosovë si një deputet, i cili ka ndihmuar njerëzit në nevojë. Tahiri njoftoi në 'Fb' se rrogën e tij të deputetit do e dhurojë për disa familje të Suharekës, për të rregulluar problemin me ujin e pijshëm. Ndërsa një rrogë më parë ashtu siç ka lajmëruar edhe më parë ka thënë se do t'ia dhurojë bilbilin të ikonës Shqiptare Nexhmie Pagarusha. Postimi i tij ka marrë me qindra komente pozitive nga ndjekësit duke uruar për deputetin dhe këngëtarin çdo të mirë në jetën e tij.



DY KOHET E NJE QYTETI

“Ideja skandaloze: Monumenti i Stalinit pse të mos rikthehet në Kuçovë?”

Nga Ylli Polovina

Haku vjen tek i zoti, thotë një fjalë e urtë. Këtë herë ajo u rikthye te Kuçova, një nga qytetet e reja më të jashtëzakonshme dhe origjinale që ka krijuar historia e popullit tonë. Perlë intensiteti dhe larmie zhvillimi brenda një treçerek shekulli, por që pluralizmi deri këto çaste, kur NATO dëshmoi interes, e pati lënë pas dore.

Mbase Aleanca Atlantike duke njoftuar vëmendjen e saj gjeostrategjike për aeroportin luftarak të Kuçovës do t'i japë një shtysë ridaljes në relief të këtij qyteti me historinë më moderne shqiptare, meritë që i ri hiqshëm duke qenë pranë një qyteti tjetër fantastik, me histori të spikatur antike e sidomos mesjetare, Beratit.

Për ne shqiptarët, por edhe për të huajt, prania turistike e të cilëve në këtë trevë po shtohet dhe patjetër nga viti në vit do të kullojë edhe më shumë, kjo që po ndodh do të thotë se kemi në dorë një aset, një çift qytetesh mjaft tërheqës për syrin dhe mendjen e botës, për shpirtin e saj plot kërshëri.

Berati dhe Kuçova janë të dy të regjistruar në kujtesën e kontinentit, edhe më tej madje. Kanë ditur të bëjnë histori.

Që Kuçova tashmë me projektin e një baze NATO bie në sy dhe me këtë rast dëshmon se ka ende karizëm, e provon çfarë rusja “Sputnik” shkroi disa ditë më parë, në 4 gusht. Lajmin e titullonte “Baza e parë e NATO-s në Ballkan do të hedhë shtat në një qytet, i cili më parë quhej Stalin”.

Autori Aleksej Vitvicki, ndryshe nga çfarë ndonjë media e Tiranës, u përpoq ta barazonte me një provokacion, ka bërë një lajm gjakftohët, sigurisht pa lënë pas dore sensacionalitetin e pranisë së Stalinit në këtë ngjarje si edhe nëntekstin se prej dikur një baze ruse Kuçova po shndërrohet në një amerikane. Thotë lajmi rus i “Sputnik”: “NATO ka vendosur të ndërtojë bazën e parë ajrore në Ballkan në afërsi të qytetit të Kuçovës, e cila që nga 1950 deri në 1990 quhej Stalin. Këtë gjë e ka shkruar në “Facebook” kryeministri shqiptar Edi Rama.

“Këshilli i Atlantikut të Veriut ka miratuar vendimin për të ndërtuar bazën e parë ajrore në Ballkanin Perëndimor në Shqipëri... NATO vetëm në fazën e parë të projektit për modernizimin e aeroportit në Kuçovë, do të investojë mbi 50 milionë euro”, ka shkruar Rama.

Kryeministri shqiptar ka pohuar se projekti do të nisë brenda një viti. Baza do të shërbejë për furnizim të NATO-s, për mbështetje logjistike dhe për kualifikimin e personelit ushtarak.

Shqipëria është anëtare e

“Kemi kaluar jo virtualisht, por në mënyrën më konkrete të mundur, nga Stalini te NATO”



NATO-s që prej prillit 2009”. Këtu mbaron lajmi i Moskës.

AVIONËT LUFTARAKË

Rritja e joshjes turistike ndërkombëtare për këtë territor fillimisht duket si nonsens me një bazë ushtarake ajrore. Në pamje të parë, sipas një logjike më të thjeshtë, duhet të pritet e anasjella: mpakja e kësaj tërheqjeje për ta vizituar, zvogëlimi, rënia.

Ja pse disa pak bashkëkombës, me t'u bërë i ditur lajmi, paralajmëruan fillimin e pasigurisë të Shqipërisë dhe ca më drejtpërsëdrejti: të popullsisë së Beratit, qytetit shumë potencial të turizmit historik që kemi. Arsyetuan gjëmëndjellësit: Botës do t'i paraqitim “Shtëpitë një mbi një” të Mangalemit apo avionët me në bark bomba dhe raketa?

Por aeroplanët e luftës në këtë aerodrom dhe territor kanë një jetë të tërë që janë ngritur dhe ulur. I pari që Benito Musolini, i cili urdhëroi, për qëllime të ekspansionit në Ballkan e së pari, për agresion ndaj Greqisë, që aeroportin e

luftës, të nisur nga kjo bazë, janë përlëshur në qiell me ata grekë dhe anglezë jo vetëm në jug të vendit, por edhe mbi Berat. Për ta rrëfyer këtë tmerr kacafytjeje të pashuar sipër qytetit ka një libër shumë të bukur studiuesi vendas Asllan Sulo.

Kur erdhën nazistët gjermanë dhe shqiptarëve u ndodhi pushtimi i ri, ky aeroport funksionoi sërish si bazë ajrore lufte dhe jo vetëm “Junker”, por edhe avionët e tmerrshëm “Stukas” ngriheshin prej këtu dhe nuk bombardonin apo mitralonin vetëm hapësirën përreth, por edhe anglo-amerikanët në anijet e tyre në Jon apo Adriatik, Fluturonin kërcënues edhe drejt veriut të vendit. Kuçova ato çaste që në kretë Shqipërinë baza më agresive e pushtuesve.

Sepse ishte kjo bazë, dhe sidomos zona naftëmbajtëse më e madhe e vendit. Duke nisur nga 12 nëntori 1943 deri në 23 korrik 1944 Kuçova u bombardua disa herë nga dhjetëra e dhjetëra avionë anglo-amerikanë, duke shkaktuar dëme materiale nëpër impiante, por edhe vranë nazistë dhe ushtarë të thjeshtë gjermanë, vranë edhe popullsi civile.

Pas lufte u duk sikur qenë jugosllavët ata që do ta merrnin përjetësisht nën kontroll këtë zonë strategjike dhe askush deri tani nuk ka treguar vëmendje se Kuçova nën thundrën e tyre që prova më e qartë se sa keq do të rrokulliseshin punët po të realizohej kjo “miqësi” me Beogradin.

Nuk është çështja që specialistët jugosllavë, të cilët po ndihmonin në rindërtimin teknik të puseve si edhe të ndonjë rafinimi të mundshëm të naftës së nxjerrë, qenë dukshëm të ftohtë e foddullë, të sigurt se ishin pushteti, por përherë e më shumë shfaqen dëshmi se disa prej tyre zbatonin direktiva të shërbimit të tyre të fshehtë UDB dhe kryenin deri edhe vrasje të inxhinierëve që nuk anonin në favor të interesave jugosllave.

Nuk është vendi në këtë shkrim, por duhet pohuar se për zotërimin e naftës së Kuçovës kacafytja e britanikëve, e francezëve dhe e italianëve në vitet njëzet e fillimin e motiveve tridhjetë të shekullit të shkruar, ishte më pak e pa besë se ajo e qeverisë titiste të pas lufte.

Rrethanat sollën ikjen pa lavdi të jugosllavëve dhe ardhjen e sovjetikëve, të interesuar për ta zhvilluar dhe fuqizuar këtë territor përtej shfrytëzimit të naftës. Kështu në 24 prill 1951 në Kuçovë u krijua Regjimentit ajror, katër mote më vonë mbërritën avionët e parë reaktivë, të fuqishmit rusë MIG.

Ato çaste situata në rajon dhe në kontinent që relativisht pa luftëra dhe Nikita Hrushovi frymëzonte bashkëjetesën paqësore mes socializmit dhe kapitalizmit. Gjithsesi aeroplanët ngriheshin në ajër për të mbrojtur sovranitetin territorial të Shqipërisë, jo për të sul-

muar kënd. Beratasit e vjetër në moshë, por edhe më të rinjtë, i mbajnë mend spektaklet e fluturimit të këtyre avionëve që, kur kalonin shpejtësinë e zërit, prodhonin në ajër një krismë tërmetore.

Baza ajrore e Kuçovës kishte të paktën një ditë të javës në të cilën i ngrinte për stërvitje ato makina luftarake. Ato kalonin me uturimë mbi kështjellë dhe qytet, duke ikur drejt malit të Tomorit, ku pas tij humbnin. Por ne e dinim ku shkonin: i afroreshin kufirit me Greqinë dhe riktheheshin.

Ne e dinim, gjithashtu, sa zgjashte kjo dhe ata shumë shpejt shfaqeshin mbi Tomor, duke e ulur shpejtësinë e mëparshme të skëtershme. Përgatiteshin për ulje. Pas kështjellës së Beratit ishte aerodromi.

Aq të mësur me këtë bazë ajrore janë banorë të Kuçovës apo të Urës Vajgurore, si edhe beratasit, sa në albumet e tyre ende ruajnë polifoto të ndryshme propagandistike të kohës, ku bashkë me pasazhin e Mangalemit, sipër kalasë, duket edhe një skuadrilje MIG-ësh.

Pra, baza luftarake ka qenë këtu. E ka dashur gjeostrategjia e ardhësve të huaj, po ashtu edhe e pushteteve vendas, edhe sovraniteti ynë sigurisht. Aleanca Atlantike nuk ka bërë ndonjë zbulim apo përdorim të ri të kësaj tradite dhe realiteti historik, të paktën që prej çastit kur në nëntor 2011 filloi rikonstruksionin e bazës. Shtatëmbëdhjetë vite të shkuara aerodromin e pati vizituar shefi i Shtabit i Ushtrisë Turke dhe kur



“
Që prej motit 1940 avionët e luftës, të nisur nga kjo bazë, janë përlëshur në qiell me ata grekë dhe anglezë jo vetëm në jug të vendit, por edhe mbi Berat.

vogël të mëparshëm civil të Otlakut, pothuaj ngjitur me Beratit, ta zgjeronte në drejtimin e kundërt, drejt Kuçovës, jetën e të cilës e kishte gjallëruar tashmë kompania italiane private e naftës, AIPA, por fort e lidhur me regjimin.

Që prej motit 1940 avionët e



hyri në tunelin nën mal të strehim-it të avionëve, i mrekulluar nga çudi inxhinierike, i ra me pëllëmbë të dorës krahut të një MIG-u dhe shqiptoi me solemnit të singërtë: “Marshalla! Mos thoni se nuk jeni shtet i fortë!”

PËR TË HEQUR FJALËN KUÇOVË

Me fazën e re të rikonstruksion-it të aeroportit të Kuçovës Aleanca Atlantike e ka përshtatur atë me realitetin e ri gjeopolitik. Do të ishte e pakuptimtë të ngjante e kundërta: dremitje e NATO-s dhe duart e kryqëzuara në pritje të Tiranës zyrtare.

Për të mirën tonë, kemi kaluar jo virtualisht, por në mënyrën më konkrete të mundur, nga Stalini te NATO.

Por Kuçova nuk ka në historinë e saj vetëm praninë e emrit të udhëheqësit bolshevik sovjetik. Ajo ka një peripeci të vazhduar të emërtimit të saj. Regjimet kanë dashur t'i imponohen këtij qyteti të ri që rritej me ditë, ta përvetësonin prestigjin e tij modern.

Italianët e quajtën fillimisht Vajgurasa.

Në 1938 bënë provën tjetër të manisë së tyre, e thirrën Devole,

duke e shpjeguar se qyteti naftëtar po krijohet buzë lumit Devoll.

Nga që sërish nuk funksionoi, pra ekzistoi më së shumti nëpër korrespondencë zyrtare apo në skicë-projektet e punës naftënxjerrëse, hyri në lojë Benito Musolini. Kish qejf t'i plotësonte një dëshirë dhëndrit të tij, ministrit të Jash-tëm Galeaco Çano, kontit që çfarë nuk bënte për t'u ngritur në shkallë fisnikërie dhe të bëhej “Duka e Madh”. Ia doli në Itali duke u shpallur “Duka i Madh i Toskanës”, por ëndërronte edhe “Duka i Madh i Shqipërisë”.

Kështu nisi një regëtimë kohe kur Kuçova gjysmë zyrtarisht filloi të thirrej edhe “Qyteti Çano”. Kjo mbase, po të mësohej populli shqiptar, i hapte rrugë titullit megaloman të ëndërruar.

Por as ky emër i ri, bartësi i të cilit do të qe shtytësi famëkeq jo vetëm i shfrytëzimit ekonomik të Shqipërisë, por edhe e pushtimit të saj me ushtri, nuk u pranua. Madje pati nga shtresa të caktuara të popullsisë, të mbushura me urrejtje ndaj pushtimit, që bënë një kundërpërpjekje po aq të habitshme. Pasi në 1943 u vra partizani i njohur vendas Tafil Skëndo, pje-

“
Kur erdhën nazistët gjermanë dhe shqiptarëve u ndodhi pushtimi i ri, ky aeroport funksionoi sërish si bazë ajrore lufte dhe jo vetëm “Junker”

sa e ndikuar edhe nga Partia Komuniste Shqiptare, nisi ta thërriste Kuçovën me emrin e dësh-morit.

Sigurisht as ky emër nuk pati jetë.

Të gjithë eksperimentonin me qytetin e ri, thua nuk u mjaftonte emri historik i territorit ku po ngrihej çudia industriale: Kuçovë. Me pak fjalë vendastit donin ta ndërrojnë të shkuarën krejtësisht, duke i ikur të shkuarës së rëndomtë të një fshati të humbur. Ndjehën se prej fjalës Kuçovë banorët prinin më shumë prestigj tingëllyes mund ta dallosh në librin “Kuçova Enciklopedi” të Shkëlqim Servet Agos, botuar nga “Argeta.LMG” në 2015.

Aty thuhet: “Për toponimin Kuçovë ka disa gojëdhëna, por po japim njëri prej tyre: Kuca ose Tokë Pjellore”. Më pas autori shpjegon se “Më i vjetri i familjes së fisit Brisqeve, Sherif Brisku, te më të rinjtë ka lënë një shpjegim kur dikush e kish pyetur nga vjen fjala Kuçovë. Sipas të parëve tanë, ky vend këtu ka qenë vetëm shkurre...Paraardhësit prenë e prenë ato sipërfaqësoret dhe thanë se tani hapëm token e re. Kur bënë të punojnë, ngectë beli në KOCKA të forta”. Më tej në këtë shpjegim tepër naiv këmbëngulet se këto rrënjë të forta të shkurreve, të thirrura nga vendasit Kuca, pak nga pak i dhanë emrin Kuçovë.

Sipas “Fjalorit Enciklopedik Shqiptar”, 2008, ky emër është gjetur në dokumentet e shkruara të kohës vetëm në vitin 1689.

Pasi u përpoqën disa herë ta tjetërsojnë më në fund ja edhe përpjekja më e fortë për ta zhdukur rrejtë të forta të shkurreve, të thirrura nga vendasit Kuca, pak nga pak i dhanë emrin Kuçovë.

zamikë. Mbajti deri në deri më 5 janar 1991, kur një vendim Kuvend-or i firmosur nga Ramiz Alia dhe Sihart Tozaj, i hapri rrugë heqjes gjithkund në Shqipëri të shenjave të Josif Visarionoviq Stalinit. Kështu në katër orë monumenti i tij në Kuçovë, me një vinç Takraft, u ul nga piedestali. Kamioni i ardhur posaçërisht nga Tirana e mori me vete.

Një punonjës policie, i cili bashkë me një skuadër të tyre ndodhje në vendin e çmontimit për të ruajtur rendin, nuk pati asnjë punë. Ky dëshmitar i superngjarjes, Qani Abazi, njeri me stof intelektual dhe lexues i njohur librash, pohon se përreth jo vetëm nuk pati ndonjë grumbullim njerëzish, qoftë edhe për kërshtëri, por dallohej hapët indiferenca.

Ishte i fundit i një qyteti me këtë emër, që hijej. Stalingradi, Stalino-gorski dhe Stalinsk në Rusi qenë censuruar që në motin 1961. Po këtë vit edhe pesë të tjerë në Armeni, Azerbajxhan dhe Gjeorgji, një në Ukrainë dhe një tjetër në Tashikistan. Ai në Bullgari afër Varnës ishte zhdukur që në 1956. Në 1961 pati ikur nga harta edhe Stalinstadti në Gjermaninë Lindore si edhe Sztalinváros në Hungari. Ai në Poloni, afër Katovicës, Stalinoqród qe hequr në 1956, kurse Ora’ul Stalin në Rumani në 1960.

(Por ka edhe më: Një shoqatë e ngritur në Kuçovë pas rënies së diktaturës propozoi që qytetit të tyre t’i vihej emri i Fan Nollit).

EJANI TË GJITHË!

Ambasadori Bashkim Pitarka, një nga yjet e diplomacisë tonë si edhe pjesëmarrës mjaft elastik në momentet e hapjes drejt Perëndimit, na ka treguar se si një funksionar i lartë i Kombeve të Bashkuara, sigurisht më shumë për një shaka, i tha në ditë në Nju Jork, ku Pitarka drejtohte misionin tonë, se Shqipëria ishte më mirë të mos e ndërronte regjimin. Shpjegimi që dha: Bota ka nevojë të ruajë një vend si muze se deri ku e katan-diste regjimi komunist një popull.

T’ia lëmë këtë “eksperiment” trillit të funksionarit dhe të kapim thelbin: joshjen turistike jo të ngrirjes së kohës, por të ndryshimit të madh. Aerodromi që përherë e më shumë do të bëhet ndërkom-bëtar në personel, e hap Kuçovën, e nxjerr nga “rrethimi” i mosvëmendjes disadekadëshe, çfarë po e nxirrte atë nga roli i peshës historike. Atë qytet në fund të fundit e kish bërë nafta, prania e vija-ur e italianëve, e polakëve dhe e çekëve, e rusëve dhe e kinezëve.

Kuçova ka qenë një Amerikë e vogël, sepse edhe punëtorët apo teknikët shqiptarë migruan aty prej qyteteve të tjera bashkëkombëse. Në këtë kuptim atje nuk ka “kuçovar” tradicional, por një shqiptar mjaft të emancipuar, plot ambicie zhvillimi dhe mbi të gjitha kulturëdashës, pra të hapët.

Për të argumentuar këtë cilësi të banorëve të këtij qyteti mjaft të veçantë ekzistojnë plot shembuj, por autori i këtyre radhëve do t’i paraqiste lexuesit njërën: Skënder Jaçen. Ai prej kohësh jeton në Tiranë. Ka qenë para vitit nëntëdhjetë përgjegjësi i kinemasë shtetërore të Kuçovës, duke e bërë këtë institucion të parin në Republikë, jo vetëm në rrjetin e madh të sindikatës, e cila atëherë quhej Bashkimet Profesionale.

Me fillimin e pluralizimit Skën-deri shkoi dhe punoi për shumë vite në Greqi. Me të ardhurat e fituara aty, ndërroi mund t’i investonte në një biznes fitimprurës, i shpenzoi ndryshe: bleu kinemanë e braktis-ruar dhe në rrrënim, duke e rikonstruktuar.

Ajo është një ndërtesë italiane e magjishme. Çatia e saj hapet dhe mbyllet si urrat e mëdha në nush-tika detare. Pajisjet e ndryshkura të kësaj mrekullie fantazie Jaçe i rinovoi, siç edhe bëri me çdo gjë tjetër në sallën e madhe të kinemasë dhe në shtojcat e saj të shër-bimit. E ringjalli këtë institucion, por jo duke shfaqur përditë filma e shitur bileta. Ai nisi të organizon-te aty, tashmë jo vazhdon prej pesëmbëdhjetë vitesh, festivale ndërkombëtare filmi. Pa biletë. Deri tani ka bërë mbi tridhjetë të tilla, duke nisur nga ai italian, francez, po ashtu edhe rus. Prej kulturës së këtij populli artistik ai ka shfaqur “Beteja e Stalingra-dit” si edhe një tuftë filmash të periudhës së shkëputjes nga regjimi i rëndë stalinian.

Në këtë festivalin kanë ardhur përherë ambasadorë, ai rus madje është mrekulluar nga mikpritja. Sepse në Kuçovë sovjetikët, që punuan në sektorin e naftës për një duzine motesh, kanë lënë një përshtypje mjaft ngazëllyese, të paharruar dhe të respektuar.

Kështu NATO e rrit praninë e vet në Kuçovë jo në një mjedis të ngarkuar me mëri apo paragjykimet etnike ose pasideologjike, prandaj ajo edhe do të ndihet më mirë, si edhe tërë shqiptarët. Sepse në jemi për miqësi mes popujve, duke mos lëshuar doemos asnjë grimë në zgjedhjen gjeostrategjike poli-tike që kemi bërë: jemi me Perëndimin dhe Aleancën Atlantike.

Monumenti i Stalinit pse të mos rikthehet në Kuçovë?

Tani, në kini edhe pak durim, po ju paraqes edhe një ide tjetër, disi “skandaloze”: rikthimin e monumentit të Stalinit në Kuçovë.

Sigurisht jo atje ku ka qenë, lart buzë kodrës dhe me dorën e shtrirë përpara bënte zotin e qytetit. Ai duhet të rrijë poshtë, në ultësirën e bulevardit të qendrës, i muzeuar dukshëm, pra i shpjeguar edhe nga ana vizuale, se para historisë dhe botës demokra-tike, ai është i mposhturi. Më saktë: është i rëndësishmi i madh, por gjithsesi i munduri.

Sepse Stalini politik, u dëshmu-a, këtu përjetohet sikur nuk ka qenë kurrë në Kuçovë. Ai, turistiku, shpresojmë të shkaktojë të kundërtën.



Opinion i Ditës

Ta çojmë diktaturën në muze!

Nga Valbona Nathanailli

(vijon nga faqja 1)

... në shtyp, i mungojnë elementët... Nisma ka vullnetin për të ndaluar me ligj simbolet e diktaturës dhe të portreteve të ish-udhëheqësve të saj, durimin për të qëmtuar e "sigluar" të gjitha veprat e artit të krijuara në diktaturë, si dhe këmbënguljen për të ndaluar ato vepra intelektuale apo artistike, të cilat përcjellin propagandë komuniste.

Por nisma është befasuese dhe surprizuese njëkohësisht, së pari, sepse është njëzet e shtatë vjet me vonesë! Në këta njëzet e shtatë vjet, në Shqipëri, është folur shumë, por është bërë shumë pak nga pikëpamja institucionale për të denoncuar të kaluarën komuniste në të gjitha dimensionet! Për të nxjerrë jashtë skenës politike të gjithë ata që udhëhoqën ndërtimin dhe fortifikimin e diktaturës. Për të ecur me shembullin e vendeve të tjera të Europës Lindore që i filluan dhe i mbyllën procese të tilla brenda dhjetëvjeçarit të parë të rrëzimit të komunizmit. Në vendin tonë, ku më shumë se viktimat janë nderuar persekutorët dhe ligji për lustracionin nuk mori kurrë miratimin e parlamentit, nisma për dekomunizimin sot të lë shijen e kafes që të shërbehet e ftohur. Është ndjellëse si ide që ke kafen përpara, por nuk pihet, sepse nuk shijon! E lë në tavolinë dhe, që të mos bësh sherr me kamerierin, paguan koston.

Fokusi i nisëm është vërtet trashëgimia negative e sistemit komunist, por është e pamundur të jesh realist dhe të mos pohosh se sistemi që lamë pas ka pasur edhe anët e tij pozitive, të ngjashme me ato të shumë vendeve të tjera të Europës Lindore. Deri në vitin 1944, kur vijmë në fuqi komunistët, Shqipëria ishte një vend krejtësisht agrar dhe i prapambetur, por falë punës dhe kontributeve të një populli të tërë, që parësisht motiveve dhe arsyeve si u vu në lëvizje, kemi një zhvillim të madh ekonomik të vendit, rritjen e nivelit arsimor të popullatës, pjesë e së cilës ishte edhe zhdukja e analfabetizimit, urbanizimin e vendit, emancipimin e gruas dhe rritjen e rolit të grupeve minoritare; ngrihen fabrika dhe shkenca ecën përpara, kemi universitetet dhe akademitë, kemi shkollat dhe librat, teatër dhe drama, filma dhe aktorë; funksionon te ushtria, ndërsa mjekësia dhe arsimit falas nuk ishin as dogmë, as propagandë, por fakt e realitet. Është e pamundur të jesh realist dhe të mos pohosh se këto arritje kanë pasur edhe anën e tyre negative, për shembull, rritja e nivelit të edukimit u shoqërua me cungimin e përmbytjes, cilësia shumë e mirë e filmave me idealizimin e "ëmbëlsimit" sistemit, futja e gruas në forcën e punës me shtimin e barrës së punëve në familje, zhvillimi ekonomik i vendit me zhdukjen e pronës private,



sikundër që të gjitha arritjet bëheshin jo në emër dhe funksion të individit, por të objektivave që vendoste Partia. Dhe është e pamundur të jesh realist dhe të mos pohosh se kjo është një trashëgimi, të cilën duam a nuk duam, na pëlqen a jo, e kemi mes nesh. Veprat intelektuale apo artistike që u prodhuan gjatë kohës së diktaturës e që vazhdojmë t'i shohim, në mos me emocion, me kuriozitet, janë copëza të një të tërë që u krijuan për 50 vjet dhe nuk mund të zhbëhen. As të ndalohen. Është njësoj si t'i thuash një "të sëmurit me diabet" mos ha ëmbëlsira! Në fakt i ha, por rrezikun e tyre e kompenson me insulinë. Insulina në këtë rast nuk është de-komunistizimi me ligje!

E kaluara përbën trashëgiminë tonë, trashëgiminë e një populli të tërë, por që për shkak të mungesës së vullnetit për ta zbardhur me sinqeritet dhe mbi bazën e objektivave të caktuara është shndërruar në një lloj pengese që po vështirëson ecjen përpara, ashtu e lënë në mes të rrugës, pa shenjat e duhura orientuese se si duhet të sillemi me të, pa manualin e saktë se si mund të kalohet. Njëzet e shtatë vjet më vonë kemi nevojë jo ta shpallim si herezi, por ta gjykojmë mbi bazën e një sistemi të ri vlerash, me sisteme të ndryshme referimi qëndrimi e përmbytjeje, me objektivin për t'i treguar brezit të ri se çfarë do të thotë të jetosh në totalitarizëm. Të paktën për hir të koston së rëndë që po paguajmë duke jetuar në tranzicionin e ndërtimit të një sistemi të ri!

Të mos harrojmë që rrëzimi i diktaturës u shoqërua me një varg

fenomenesh që për një pjesë të madhe të popullsisë ishin të panjohura deri në vitet 1990: kemi rritjen e krimit dhe të ndasive sociale, mungesë stabiliteti dhe papunësi, arsim dhe mjekësi të papërshtatshme për një pjesë të mirë të popullsisë, punë të pasigurt dhe rropatje për të gjetur banim, shtuar notat e nostalgjisë me kalimin e viteve. Të gjitha bashkë dhe secila veç e veç mjaftojnë për të rivlerësuar të kaluarën dhe për të reaguar ndaj saj mbi bazën e interesave shumë të ngushta, nga një popullsi që ndjenjat dhe emocionet, kujtimet dhe adresimet e kësaj të kaluarë i shtrihen në një segment shumë të gjerë, me vlera pozitive e negative.

Nisma është befasuese dhe surprizuese njëkohësisht, së dyti, sepse nisma e këtij grupi intelektualësh që kërkon ndalimin e transmetimit të filmave apo mosbotimin e veprave të caktuara revokon veprimet dhe akte që janë të denjta vetëm për vende totalitare. Në Gjermaninë naziste, në vitin 1929, u ndalua libri i Remarkut "Asgjë e re nga fronti i perëndimit", me arsyen që fyente regjimin në fuqi, në Bashkimin Sovjetik, në vitin 1944 u ndalua libri i Xhorxh Oruell "Ferma e Kafshëve", ndërsa në Arabinë Saudite edhe sot ndalohet shpërndarja dhe leximi i Biblës. Në rastin tonë, duket sikur nisma ka dalë nga raftet e Arkivit të Shtetit Shqiptar për periudhën e pushtimit italian. Nicola Lo Russo Attoma, Drejtor i Përgjithshëm i Shtypit, Propagandës dhe Turizmit, gjatë periudhës së pushtimit italian të Shqipërisë, kishte detyrë të evidentonte dhe të ndal-

onte hyrjen në vend, nxjerrjen jashtë qarkullimit, ose heqjen nga salla e leximit të bibliotekave private dhe shtetërore të të gjithë librave, me natyrë filozofike, sociale a politike, që flisnin kundër sistemit. Vetëm gjatë periudhës 27 janar 1940 - 20 dhjetor 1940, Attoma i ka dërguar plot 16 shkresa Ministrisë të Arsimit të kohës, z. Ernest Koliqi, nëpërmjet të cilave i komunikonte titujt e librave të ndaluar, ndërsa numri i titujve të ndaluar, për të njëjtën periudhë, në total është 79. Në çdo shkresë të dërguar, numri i librave të ndaluar luhatej: nga një titull, si për shembull në shkresën e dt. 1 maj 1940, nëpërmjet së cilës ndalohet vetëm libri me titull "A peace front and the axes power", në pesëmbëdhjetë tituj, në shkresën e dt. 21 mars 1940, nga mund të veçojmë shpalljen si të padëshiruarat të veprës së autorit Riccardo Bachi (botim i vitit 1926) me titull "L'alimentazione e la politica annonaria in Italia", si dhe veprën e autorit Giorgio Mortara (botim i vitit 1925, me titull "La salute pubblica in Italia durante e dopo la guerra").

Së fundmi, vetë nisma mban erë "MekKartianizëm". Për të gjithë ata që nuk janë familjarë me politikën amerikane, në fillim vitet 1950, instalimi i sistemit komunist në vende të ndryshme të botës trembi shumë amerikanë, veçanërisht kur Bashkimi Sovjetik doli si një superfuqi bërthamore. Historia amerikane antikomuniste gjeti rrugën e hyrjes në politikë falë senatorit të Uiskonsinit, Jozef MekKarti, një demagog në kërkim të vëmendjes, i cili arriti të shndër-

rohet në krye lajm për të gjitha mediet amerikane kur më 9 shkurt 1950 deklaroi: "Kam në dorë një listë me 205 emra komunistësh, që i janë bërë të njohur edhe Sekretarit të Shtetit, por që përsëri vazhdojnë të punojnë dhe formësojnë politikën e Departamentit të Shtetit". Por sekretari mohoi lajmin, lista nuk u publikua asnjëherë, ndërsa vetë burimi, i entuziazuar pafund nga vëmendja që mori mbijetoi në politikën amerikane pak kohë, sepse u braktis nga të gjithë. Së fundmi, Senati votoi t'i censurojë fjalën, gjë që praktikisht shënoi edhe fundin e karrierës së MekKartit. Kishte shkelur çdo normë besueshmërie.

Në Shqipëri ka ardhur koha të flasim për periudhën e komunizmit si pjesë të historisë sonë. Të përiqemi t'ia tregojmë e kalojmë brezit të ri të vërtetat rreth socializmit jo me ligje dhe me dekrete, por me aktivitetet, filma, libra, portrete, simbole e drama, pak a shumë atë që bëri diktatura për veten e saj, por tani ta bëjmë me për veten tonë. E bën dot kjo nismë? A është në gjendje nisma ta çojë të kaluarën tonë në sallat e muzeve? A është në gjendje nisma të na nxisë të tregojmë sa më shumë ngjarje të vogla dhe të mëdha, të bukura dhe të shëmtuara, të hidhura dhe të ëmbla nga e kaluara jonë në diktaturë? A është në gjendje nisma të na nxisë ta shpëtojim të kaluarën jo si një hon ku kemi gëzuar 50 vjet punë e përpjekje, por si një urë që duhet t'i forcuar këmbët, përndryshe do kemi tragjedi të ngjashme me atë të Xhenovas, vetëm se në këtë rast viktimë do të ishte i gjithë populli.

Opinion *i* Ditës

Një Shqipëri e fortë apo një shërbëtore e BE-së?!

Nga Taulant MALAJ

(vijon nga faqja 1)

... Shqipërinë, ndezin motorët e integritimit europian. E ndërkohë trumbetojnë me të madhe se sa e mirë është Europa, se sa shumë punojnë ata që shqiptarët të jenë sa më shpejt pjesë zyrtare e shërbëtore të madhe evropiane etj.

Në fakt, ajo që thonë në televizione e media të shkruara është një megalomani e pështirë, sepse janë po ata që e kanë lënë "integritimin" të zvarritet për vite e vite. Madje, ka nga ata që kaq shumë e duan integritimin, sa që edhe forcën politike e kanë quajtur të tillë, mbase nga reminisencat e kohës së monizimit, kur fëmijës i vihej emri i udhëheqësve, si p.sh. Marenglen (Marks, Engels, Lenin).

Por sa e duan ata vërtet integritimin, dhe a duhet të jemi kaq të verbër pro tij?!

Anëtarësimi i plotë në Bashkimin Europian natyrisht që ka përparësitë e tij. Kryesisht ato lidhen me unifikimin e sistemit ekonomik dhe juridik me atë të BE-së. Kjo në vetvete shton shpresën se, mbase një ditë edhe ato reforma që më së shumti kanë çaluar në këtë vend do mund të kthehen në rrugën e duhur, drejt një drejtësie, ashtu siç edhe e ka emrin, apo një sistemi ekonomik të bazuar në konkurrencë të pastër, dhe jo në nënshtrimin ndaj parasë informale. Po ashtu, të qenit anëtar i BE-së do të thotë se mundësitë e punësimit në vendet e BE-së do jenë më të larta, por duke pranuar se ata do tërheqin ata individë që posedojnë aftësitë për të cilat ka nevojë tregu i tyre i punës. Deri këtu gjithçka duket më se e pranueshme dhe për të cilën do duhet punuar fort.

Por a është BE një fushë me lule dhe çfarë merr BE-ja në këmbim të anëtarësimit të vendeve të reja?

Nëse keni parasysh një klub shoqëror privat, anëtarësimi në atë klub është kundrejt një pagese vjetore, në këmbim të së cilës më së shumti merr të qenit pjesë e tij, pra një lloj stimulimi apo statusi shoqëror. Sa më elitare të jetë anëtarësia e klubit, aq më e lartë është edhe pagesa për të qenë pjesë e tij. Ka nga ata që për të krijuar idenë e të qenit "dikush" shpenzojnë gati krejt të ardhurat e tyre për pagesën e anëtarësisë apo edhe arrijnë deri aty sa hyjnë në borxhe për të paguar atë, duke menduar se një ditë do arrijnë disa të rimarrin çfarë kanë shpenzuar.

Por sa mund të mbajë "mashtimi"?

Shqiptarët kanë 28 vjet që rëndin nga një klub në tjetrin, dhe gjithnjë e më shumë, administratorët e këtyre klubeve e kuptojnë se nuk jemi gati për të. E megjith-



atë, herë pas here shtojnë kërkesë pas kërkesë si ajo shprehja "tërhiq e mos e këput". Kjo gjendja "as këteje, e as andej", përveç administratorëve të "klubeve shoqërore elitare" të botës, u shkon për shtat më së shumti politikanëve shqiptarë, të cilët vazhdojnë të pasurohen ora-orës pa as më të voglin shqetësim dhe me bindjen e plotë se, kur të vijë momenti i anëtarësimit të plotë në BE, do mund të aplikojnë një amnistitë të pasurive të tyre. Kësisoj, shpresojnë ata, gjithçka kanë krijuar nëpërmjet mashtimit, vjedhjes, kriminalitetit të organizuar etj., në gati 30 vjet, do mund të shëndërrohet në pasuri legjitime, e aftë të konkurrojnë me paskanikët e trashëguar ndër shekuj në botën perëndimore. Pra, BE do të jetë shpëtimi i tyre, por që nuk janë ende gati, sepse duan më shumë. Atë që kanë vjedhur deri më tani nuk është mjaftueshëm. Kanë arritur deri tek brezi i 10-të, por duan më shumë...

Në planin ekonomik, shqiptarët do mund të përfitojnë disa mijëra vende pune nëpër vendet e BE-së, por në këmbim do duhet të japin "jetën" e tyre, sepse ata që do rrinë në trojet shqiptare, domosdoshmërisht shumica e tyre - sepse anëtarësimi në BE nuk nënkupton merr plaçkat e shko jeto poshtë urës në Paris, Romë, Bon, Bruksel etj. - do të kthehen në konsumatorë

funksionale të produkteve e shërbimeve të kompanive nga BE-ja. Prodhimet e tyre vendase dhe bio nuk do mund të konkurrojnë financiarisht me prodhimet jo-bio dhe shumica të ngrira të kompanive nga BE. Ekonomikisht, kompanitë e BE-së nuk do kenë interes të zhvendosin linjat e tyre të prodhimit në trojet shqiptare, sepse shqiptarët janë "krenarë" për veten e tyre dhe s'pranojnë të punojnë për pak para, edhe pse mund të përfundojnë poshtë urës nga skamja. Së dyti, ato linja prodhimi që do krijonin punësim tashmë po mbulohehen me përdorimin e linjave robotike.

Sa i qëndrueshëm është klubi "privat" shoqëror i quajtur BE?!

Bashkimi Evropian, në vetvete, është bashkim vullnetar. Që të funksionojë siç duhet do duhet të ketë një bashkërendim të politikave ekonomike, sociale, të mbrojtjes dhe ato politike. Ndërsa duket se 3 të parat janë pak a shumë të bashkërenduara - pasi shoqëritë evropiane kanë hequr tashmë kufijtë mes tyre duke i lënë më shumë hapësirë bashkëjetësës sociale mes popujve të tyre, dhe për sigurinë e të cilëve mendon NATO - në planin politik duket se janë shumë më të parhatsëshme bashkëjetësitë e tyre. Kohë pas kohe, sidomos kohëve të fundit me rritjen e niveleve të nacionalizmit apo radikalizmit të djathtë, qever-

itë evropiane duket se po krijojnë një lloj hendeku me qeverinë e përbashkët në Bruksel.

Zërave dhe diferencave politike dalëngadalë po u shtohen edhe pasojat ekonomike. Marrëdhëniet jo të mira së fundmi mes Brukselit dhe Uashingtonit duket se nuk po u ndihmojnë krisjeve brenda Unionit. Gjithnjë e më tepër shihet se po rriten përqindjet e skeptikëve dhe kundërshtarëve të këtij unioni. Për aq kohë sa do ketë shoqëri që duan të anëtarësohen në klub, atëherë klubi do mund të ekzistojë në sajë të rregullave të kërkesë-ofertës. Por kur kupton se do jesh mbase anëtar i fundit që anëtarësohet para falimentimit të tij, çfarë vlere ka ai anëtarësim?!

Ndërkohë, shqiptarët votues mbeten po ata që ishin; partizanë të zjarrtë të anëtarësimit në një klub, që më shumë do t'i detyrohen se sa do përfitojnë prej tij. Jo qundërërisht, ekranet e televizioneve dhe faqet e mediave të shkruara e atyre elektronike janë të mbushura me "ushtarët" e politikaneve, që nën moton e anëtarësimit në BE, mbajnë gjallë pish-tarin e hajdutërisë së tyre gati 30-vjeçare. Teksa populli shqiptar endet rrugëve të mjerimit, në kërkim të kafshatës së bukës për nesër, pa e kuptuar se po u shërbën me devotshmëri hajdutëve të djeshëm e të sotëm, të veshur me kostume politike.

HOROSKOPI

DASHI

Dita më e mirë për të përmirësuar shëndetin tuaj. Bëni kujdes që të mos përfshiheni në marrëveshje të dyshimta financiare. Një person që e keni konsideruar gjithmonë armik në punë do të rezultojë një aleat.

DEMI

Mbrëmja juaj do të jetë e mbushur me emocione të përziera, të cilat mund t'ju mbajnë të tensionuar. Por nuk ka nevojë të shqetësoheni shumë, pasi pasdija juaj do t'ju japë më shumë gëzim sesa zhgënjim.

BINJAKET

Kultivoni në zemrën tuaj një natyrë harmonike sepse ndikon pozitivisht në të ardhmen. Mos i ndani çështjet tuaja personale me të njohurit e rastësishtëm. Gëzoni ekstatën e dashurisë në maksimum.

GAFORJA

Një udhëtim i papritur mund të jetë i mundimshëm. Mos bëni investime në xitime sipër, sepse humbjet financiare do të jenë të sigurta. Sot do të keni mëzri veçanërisht në vendin e punës.

LUANI

Personaliteti juaj do të veprojë si parfum sot për njerëzit që keni përreth. Marrëdhënia me bashkëshortin tënd mund të tensionohet për shkak të ndërhyrjes së padëshiruar të të huajve.

VIRGJERESHA

Mundohuni të kontrolloni emocionet tuaja sidomos zemërimin. Mundësitë e reja për të holla do të jenë të shumta. Ju, gjithashtu, do të krijoni kontakte të rëndësishme përmes miqve.

PESHORJA

Sot ju mund të merrni përgjegjësi shtesë në vendin e punës gjë që do të çojë në pagë më të lartë dhe në një pozicion më të mirë. Bëni kujdes për një individ që mund të përpiqet t'ju mashtrojë ose t'ju japë informacion fals.

AKREPI

Sot do të keni dëshirë të theksuar për të udhëtuar dhe për të shpenzuar para. Do të zgjeroni bazën tuaj të miqve dhe të njohurit dhe merrni pjesë në festa dhe aktivitete sociale.

SHIGJETARI

Tregoni më shumë kujdes kur ngisni makinën. Problemet financiare dëmtojnë aftësinë tuaj për të menduar në mënyrë konstruktive. Një mik i vjetër do të bëjë një vizitë të papritur duke ju sjellë kujtime të këndshme.

BRICJAPI

Mos jepni kështilla ku nuk kërkohet. Edhe sugjerimet mbajnini brenda kufijve. Marrëdhënia juaj e dashurisë po bëhet magjike. Mos u shoqëroni me njerëz që mund të dëmtojnë reputacionin tuaj.


UJORI

I dashuri juaj do të kërkojë më shumë përkrahim nga ana juaj. Mos bëni premtime që nuk i mbani dot. Ditë e mirë për të dërguar CV-në tuaj ose për të dhënë një intervistë pune. Shume ndryshime mund të ndodhin në minutat e fundit.

PESHQIT

Ju mund ta keni të vështirë të mbani nën kontroll emocionet tuaja sot. Sjellja juaj e pazakontë do të ngatërojë njerëzit rreth jush dhe t'ju bëjë të zhgënjyer. Edhe situata financiare nuk është pozitë më optimale.

KOMBËTARJA PRET IZRAELIN



Eros Grezda, i dëmtuar në ndeshjen miqësore mes Shqipërisë dhe Norvegjisë duket se është gati për ndeshjet që Shqipëria do të luajë në kuadër të Ligës së Kombeve. Në një prononcim për "Supersport", ai ka folur në lidhje me gjendjen e tij dhe me mungesat që ka skuadra në këto kohë, ndërkohë që ka treguar edhe objektivat që ka për sezonin e ardhshëm me Osijekun.

RIKUPERIMI
"Kam kaluar një fazë të vështirë dhe tani jam në fazën e rikuperimit dhe kam nisur stërvitje me ekipin. Dua të jem në formën më të mirë jo vetëm për të ardhurat, por për të qenë gati për ndeshjet në shtator".
MUNGESAT
"Roshi dhe Sadiku kanë treguar se janë të rëndësishëm dhe më vjen keq që nuk do të jenë për ndeshjet

Premtimi i Grezdës: Jam gati në shtator

e radhës nga dëmtimi i rëndë, por nëse rikuperohem unë do të bëj maksimumin për të ndihmuar skuadrën dhe mbushur vendin e tyre në një formë. Është problem pasi shumë lojtarë nuk kanë klube dhe disa të tjerë janë të dëmtuar, por nuk varet nga 1-2

apo 3 lojtarë pasi kemi lojtarë kualitativ që mund të përfaqësojnë vendin tonë dhe Panuçi mund të bëjë më të mirë që janë për momentin. Kam folur vazhdimisht me të dhe më ka pyetur për gjendjen e i kam thënë se kam nisur përgatitjet me skuadrën dhe se

gjithçka po shkon mire".
OSIJEKU
"Objektivat e skuadrës ishin që të shkonim në Europë dhe këtë vit duam të fitojmë Ligën pasi kemi një ekip të mirë dhe kemi bërë përf forcime. Ende nuk kam filluar, por javën tjetër pritet të kem ndeshjen time të parë zyrtare për këtë sezon dhe shpresoj të bëjmë më mirë se vitin e kaluar", - u shpreh Grezda.

Korçarët, 5 ndeshje me dyer të mbyllura në shtëpi, të kuqtë 4 ndeshjet e radhës pa tifozë

Disiplina "burgos" Skënderbeun e Partizanin, por dënimet mund të ishin edhe më të rënda

Mbrojtësi ka peng Ligën e Europës



Jeton Selimi

Pesë ndeshje pa tifozë për Skënderbeun në shtëpi, katër ndeshje radhazi pa tifozë për Partizanin dhe nga një gjobë e majme, respektivisht prej 3 milionë lekësh për korçarët dhe 2 milionë për Partizanin. Këto kanë qenë verdiktet e dhëna nga Komisioni i Disiplinës në FSHF për incidentet e ndodhura gjatë takimit Skënderbeu-Partizani. Në një situatë të tillë të rëndë, duket se klubet ia kanë hedhur paq me dënimet e dhëna...

Dhuna e ndodhur në Korçë gjatë ndeshjes Skënderbeu-Partizani ka qenë në qendër të shqyrtimit nga ana e Komisionit të Disiplinës. Disiplinori pasi është njohur me materialet e delegatit, vëzhguesit dhe gjyqtarit Hamiti, ka analizuar situatën duke dhënë ndëshkimet e mëposhtme për të dyja klubet: 1) "KF "Skënderbeu", për sjellje të gabuar të spektatorëve duke përdorur mjete ndezëse, hedhur gurë brenda rrethimit të fushës duke shkaktuar akte dhune dhe



ndërprerje të përkohshme të ndeshjes kundër FK "Partizani", në bazë të nenit 66/1 dhe 66/3/b) të KDS dënohet me gjobë në masën 300.000 (treqindmijë) lekë dhe zhvillimin e 5 (pesë) ndeshjeve pa spektatorë në stadiumin përkatës". 2) "FK "Partizani", për sjellje të gabuar të spektatorëve duke përdorur mjete ndezëse, hedhur gurë brenda rrethimit të fushës duke shkaktuar akte dhune dhe ndërprerje të përkohshme të ndeshjes kundër KF "Skënderbeu", në bazë të nenit 66/1 dhe 66/3/b) të KDS dënohet me gjobë në masën 200.000 (dyqindmijë) lekë dhe zhvillimin e 4 (katër) ndeshjeve pa spektatorë". Në fakt, parë agravinin e sit-

uatës në Korçë, këto dënime ngajnë si një përkëdhelje për Skënderbeun e Partizanin, duke parë se Kodi i Disiplinës Sportive parashikon dënime edhe më të rënda për situata të ngjashme. Por duke qenë se ishte vetëm java e parë e kampionatit, mesa duket në federatë nuk e kanë parë të udhës të japin ndëshkime më të rënda që në 90 minutëshin e parë. Gjithashtu, ndër vendimet e tjera të Disiplinës ishte edhe ndëshkimi me dy ndeshje për presidentin e Laçit, Pashk Laska, pasi në takimin e vlefshëm për Superkupën e Shqipërisë Laçi-Skënderbeu, që u fituar 3-2 nga korçarët, ka qëndruar në sektorë të fushës e stadiumit ku nuk i lejohej.

Mbrojtësi te Verilindorët

Krasniqi prezantohet, Kukësi bën gafën e radhës



Ashtu siç ishte lajmëruar në media, Gëzim Krasniqi ka firmosur zyrtarisht me skuadrën e Kukësit dhe sot është prezantuar pranë zyrave të klubit, nga drejtori sportiv i verilindorëve, Nderim Nexhipi. Gëzim Krasniqi bëhet kështu mbrojtësi i dytë që prezantohet brenda pak ditësh, duke qenë se më parë ishte prezantuar edhe Ardiان Cuculi, një tjetër ish-futbollist i Partizanit. Në këtë mënyrë, Kukësi plotëson vendet e lëna bosh nga largimet e Rustem Hoxhës dhe Albi Allës. Sezonin e fundit, Krasniqi ka qenë pjesë e Rabotniçkit në kampionatin maqedonas, ndërkohë që në të kaluarën e tij, ka luajtur edhe me fanellën e Partiza-

nit për disa sezone dhe është një njohës i mirë i Kategorisë Superiore. Në fakt, drejtuesit e Kukësit kanë harruar që sezonin e fundit, Krasniqi ka qenë pjesë e Rabotniçkit në Maqedoni dhe jo e Partizanit. "Gëzim Krasniqi është futbollisti i radhës që ka nënshkruar me FK Kukësin. 28-vjeçari vjen nga radhët e Partizanit ku ka luajtur për

pesë vite. Ai ka nënshkruar me klubin tonë një kontratë njëvjeçare me të drejtë rinovimi për një vit. Krasniqi luan në pozicionin e qendërmbrojtësit, dhe është njohës i mirë i Kategorisë Superiore, pasi sezonet e fundit ka luajtur rregullisht në kampionatin shqiptar", shkruej në njoftimin e klubit verilin-

Dënimet e dhëna nga Disiplina do të ndikojnë dhe në ecurinë e Skënderbeut dhe Partizanit. Në bazë të këtij dënimi, Skënderbeut i takon ta mbyllë fazën e parë të kampionatit pa tifozë në stadiumin e tij, madje edhe ndeshjen e fazës së dytë me Kastriotin. Mbetet për t'u parë, nëse drejtuesit do të vendosin të paguajnë pasi të shlyet gjysma e dënimit, që i bie tri ndeshje, apo jo.

E sigurt është që korçarët do të luajnë pa tifozë në ndeshjet me Laçin, Tiranën dhe Kukësin, që janë tri të radhë në stadiumin "Skënderbeu". Nëse drejtuesit e klubit paguajnë, tifozët mund të kthehen ndaj Kamzës në javën e 9-të, nëse jo atëherë do të kthehen në javën e 13-të

Dënimet, çfarë humbasin klubet


Partizani shpëton derbin, Skënderbeu luan me tifozë në fazën e dytë



ndaj Flamurtarit. Nga ana tjetër, Partizani do të luajë pa tifozë në 4 sfida, ato kundër Kamzës, Kastriotit, Laçit dhe Flamurtarit, por një lajm i mirë për "demat e kuq". Për derbin kundër Tiranës, tifoze-

ria e kuqe do të jetë e pranishme në stadium, pasi dënimi i FSHF skadon. Gjithsesi të kuqtë mund të jenë që në transfertën e Laçit, nëse drejtuesit vendosin të paguajnë gjysmën e dënimit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Riza aktor.
7. Një fjalë si hij.
11. Një mund të jetë diplomatik.
12. Premton të bëhet as.
14. Janë felinë... të zinj.
16. Ami i Maupassant.
18. Heroi i Emilio Salgarit.
19. Qe anarkist i famshëm rus
21. Një mungesë gjaku.
22. Susanna shkrimtare
23. Të parat në cilësi.
25. Mbyllin një shtëpi.
26. Mbeten në fund.
27. Qendër në kaos.
28. Ka bërë piktoreskë një i tillë
30. Inicialet e Camus.
31. Motra...e Kolë Idromenos
33. Një konfuzion total.
34. Rastet pa set.
36. Rastisin në krye.

37. Fillojnë detyrën.
38. Bektashi këngëtare.
39. Andrea aktore.
41. Sampras i tenisit.
43. Shkroi Korbi (indic).
44. Triolet e Trëndafilë me kredi.
46. Kilmer aktor.
47. Në krye të robotëve.
49. Unë dhe ti.
50. Një mund të jetë fetar.
51. Stephane poet francez

VERTIKAL

1. Fillojnë praktikën.
2. Britma e Arkimedit.
3. Ekstreme në trap.
4. Në fund të fundit.
5. Janë fjetoret e ushtarëve
6. Parker regjisor.
7. Vivaldi kompozitor.
8. Një shkop për karambol.
9. Janë firmat rentiere.
10. Një i fundit mbi të gjithë
11. Kufizojnë tatimet
13. Janë nomadë.
15. Panik pa kufij.
16. Fryn detin
17. Sidney regjisor i Serpico.
18. Jep alarmin.
20. Fillojnë nazet.
24. Janë llogari.
25. Alan regjisor.
29. Roman regjisor.
32. Eshhtë X ajo e sulmit.
33. Kapen të parat.
35. Një provë... intelligence.
37. Një markë lap top.
40. Fillojnë matjet.
41. Rruga e Ferenc Molnar.
42. Qerre pa qe.
45. Fillojnë lirinë.
46. Fillojnë vallen.
48. Në mes të thomës.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Një doktor... i Fritz Lang
6. U paraprinë hoteleve.
11. Kush nuk ka... nuk ha
13. Eshhtë djall
14. Një mund të ketë i rrallë.
15. Ishin perëndi të Samotrakias.
17. Institucione Botuese Autonome.
18. Eshhtë infeksion në bark.
20. Fundi i një samurai.
21. Një markë kafeje.
22. Mbyllin një hark.
23. Mund të jetë emërore.
25. Ishite muzikanti që nuk përsiste.
28. Në krye të avokatëve.
29. Qerre pa qe.
30. Një pjesë e adoleshentëve.
32. Një banor imagjinar i planetit të kuq.
35. Nuk shuhej dot nga Tantali.

VERTIKAL


36. Desnuda e Goya-s.
37. Ruhet ajo sportive.
39. Vetëvrasia e samurait.
41. Drita pa kufizj.
43. Eshhtë yll i skuadrës.
44. I dashuri i Aidas.
46. Eshhtë zhurmë
47. Ishite lulja e harresës.
1. James. armiku i Sherlock Holmes.
2. Eshhtë edhe ajo saudite.
3. Imami aktore
4. I kanë çift turket.
5. Inicialet e Seagal aktor.
6. Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
7. Në fund të lutjes.
8. Eshhtë sporti me stil të lirë.
9. Mbeten në fund.
10. Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
12. Conan ai i Schwarzenegger.
13. Gjysmë ditari.
15. Mario, që qe bomber argjentinias.
16. Mund të prishej nga një... kleçkë.
18. Në hyrje të pistës.
19. Një numër... femrash.
21. Eshhtë qyteti i Besës
24. Qyteti që qhej edhe Sebaste.
26. Njëloj për latinët.
27. Mund të bëjnë stil të lirë.
31. Damon aktor.
33. Eshhtë pije e jona.
34. Në krye të noterëve.
36. Film i Robert Altman.
38. Skuadra merengue.
39. Një pjesë e hasmërisë.
40. Rrallë është përgjysmë.
42. Nisur pa kufij.
45. Fillojnë mobilizimin.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)
FJALËKRYQI (2)



SUDOKU

			6						
	5		1					9	6
8	9				7				
4		8		3			9		
			5	6	7	1	3		4
1		3				9		6	
	3						6	2	
			1	2	8				
							3		

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	6	3	9	2	4	8	7	5
8	9	4	5	3	7	1	2	6
7	2	5	6	8	1	3	9	4
2	8	1	7	6	5	9	4	3
3	4	7	1	9	2	5	6	8
9	5	6	8	4	3	2	1	7
4	3	8	2	7	9	6	5	1
6	1	9	4	5	8	7	3	2
5	7	2	3	1	6	4	8	9

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2	1	11	2	7		
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	
1	12	4	2	12	4	11	6	1	8				
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2		
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12	
3			5	10	3	1	14	4	6	1			
4	12	2	5	1	7	2	12		11	4	3		
7	10	6	10	14	4	8		12	10	7	4		
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8	
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14	
7	2	14	4	12		7	K	U	9	S	H	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12	

T	E	K	B	O	M	B	R	E	D	H	
O	R	A	T	O	R	E	T	E	S	E	
G	N	O	T	A	R	E	T	T	M	T	
E	A	M	E	R	I	K	A	N	E	T	
R	S	L	R	E	T	E	R	I	K		
S	P	E	L	O	T	A	D	V	M	A	
S	O	T	R	T	A	R	E	T	E	T	
T	R	G	P	A	R	E	T	E	T	E	
E	T	L	A	R	I	T	M	I	A		
F	I	L	I	Z	A	T	E	A	G	A	
A	D	I	T	E	T	T	O	M			
N	O	B	I	L	E	B	A	N	A	L	E

Argëtim filozofik

- Të gjitha qeveritë vuajnë nga një problem endemik: Pushteti tërheq personalitetet e çrregulluar.

- Suksesi në jetë është rezultat i gjykitimit të mirë. Gjykimi i mirë është zakonisht rezultat i përvojës. Përvoja është zakonisht rezultat i gjykitimit të gabuar.

- Revolucionet nuk i bënë të urrejtur, por të ngopurit që kishin tre ditë pa ngrënë.

Thënie të mënçura

- Sa më shumë bëni, aq më shumë mundeni.
- Asgjë nuk mund të na bindë se arti është i pavdekshëm. Bota mund të jetë edhe pa letërsinë. Mirëpo, më lehtë do ta kishte edhe pa njeriun.
- S'është fatkeqësi të jesh i njohur për keq tek njerëzit, fatkeqësi është t'i njohësh keq njerëzit.

- Një njeri me guxim është shumicë.
- Në goftë se mundeshim të shisnim përvojat tona me çmimin që na kushtuan, do të ishim të gjithë milionerë.
- Njeriu i kuptueshëm i përshatet botës, i pakuptueshmi vazhdimisht mundohet t'ia përshatë botën vetvetes.

